**KOMUNA E DEÇANIT**

Për qytetarët.
Me përgjegjësi.



# RAPORT **GJASHTË MUJOR** **I PUNËS**

**PERIUDHA**
Janar – Qershor 2026

**RAPORTOI**
Kryetari i Komunës

**PËRGJEGJËSI.**
**TRANSPARENCË.**
**ZHVILLIM.**

VITI
**2026**

**PËRMBAJTJA**

**Hyrje** ........ 2

**ZYRA E KRYETARIT** ........ 2

**Zyra për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun** ........ 3

**Zyra e Prokurimit** ........ 6

**Zyra e Auditorit të Brendshëm** ........ 7

**Zyra për Komunitete dhe Kthim** ........ 10

**DREJTORIA PËR ADAMINISTRATË** ........ 12

**DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM HAPËSINOR DHE MBROJTJE TË MJEDISIT** ........ 13

**DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA** ........ 21

**DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE** ........ 34

**DREJTORIA PËR ARSIM** ........ 67

**DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL** ........ 87

**DREJTORIA PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE SHËRBIME PUBLIKE** ........ 89

**DREJTORIA PËR INSPEKCION** ........ 104

**DREJTORIA PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM** ........ 107

**DREJTORIA PËR GJEODEZI DHE KADASTËR** ........ 117

**DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT** ........ 119

## Hyrje

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës së Deçanit i datës 31.10.2019, si dhe në Planin e Punës së Kryetarit dhe Qeverisjes Komunale 2026, paraqesim raportin gjashtëmujor të punës për periudhën Janar - Qershor 2026.

Raporti pasqyron rezultatet e arritura, aktivitetet dhe angazhimet e Drejtorive Komunale të Komunës së Deçanit, si dhe njësive të cilat veprojnë në kuadër të zyrës së kryetarit gjatë periudhës raportuese Janar – Qershor 2026.

Zyra e kryetarit gjatë kësaj periudhe është angazhuar maksimalisht për organizimin sa më të mirë të të gjitha aktiviteteve të organizuara nën patronatin e kryetarit të komunës si dhe organizimin e takimeve të ndryshme.

### ➢ Zyra e Kryetarit

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2026, Zyra e Kryetarit të Komunës së Deçanit ka kryer këto punë:

- Organizimin e takimeve protokollare të kryetarit të komunës;

- Evidentimin dhe mbikëqyrjen e takimeve të kryetarit të komunës;

- Përgatitjen e takimeve të kryetarit me delegacione të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, nga niveli qendror dhe lokal;

- Ka pranuar **1,280** lëndë të protokolluara, nga të cilat janë kërkesa të ndryshme, **208** vendime, kontrata, memorandume, marrëveshje, shkresa, njoftime etj.

Nga këto kërkesa **105** prej tyre në vlerë prej **52,500.00** euro janë bërë vendime për subvencionim të personave me sëmundje malinje, **15** janë bërë vendime për subvencionim të personave me kushte jo të mira financiare, **3** vendime në vlerë prej **4,250.00** euro janë bërë pagesa për mbulimin e shpenzimeve të qirasë për familjet me raste sociale, **217** studentë kanë përfituar bursa në vlerë prej 400 euro, në total janë ndarë **86,800.00** euro.

Kemi nënshkruar **6** Marrëveshje / Memorandume Bashkëpunimi për projekte të ndryshme, si:

- Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për bartjen e pasurisë – salla e edukatës fizike në Sh.F.M.U “Tafil Kasumaj”;

- Memorandum Mirëkuptimi me Qendrën për Mirëqenien e Gruas – Strehimorja për viktima të dhunës në familje;
- Marrëveshje Bashkëpunimi me Qendrën Kombëtare të mjekësisë së punës në Gjakovë;
- Memorandum Bashkëpunimi me Fondacionin për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik – PREDA Plus Kosovë dhe WEmtrepreneur;
- Marrëveshje Bashkëpunimi me KRU "Drini i Bardhë" Sh.A Pejë, për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanale të ujitjes në tërë territorin e Komunës së Deçanit;
- Marrëveshje Kontributi me Programi i Kombeve të Bashkuara për vendbanimet njerëzore (UN-Habitat);

Gjatë këtij gjashtë mujori të parë të vitit 2026, kemi nënshkruar **2** kontrata publike dhe kemi filluar punimet në projekte të ndryshme, si:

- Ndërtimi i katër urave që të qon në Roshkodol dhe parkut në Isniq – Punë shtesë – në vlerë prej **17,200.00 €**
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik dhe institucioneve publike në Deçan – në vlerë prej **124,000.00 €**

## ➢ Zyra për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun

Gjatë periudhës Janar - Qershor, Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun në Komunën e Deçanit ka përcjellë në vazhdimësi aktivitete ditore, javore dhe mujore, të cilat janë publikuar edhe në faqen zyrtare të internetit të komunës https://kk.rks-gov.net/decan/ dhe në profilin zyrtar të Komunës në Facebook.

**Fokusi kryesor i punës** ka qenë përcjellja dhe publikimi i të gjitha aktiviteteve të Kryetarit të Komunës, z. Bashkim Ramosaj, si dhe i aktiviteteve të institucioneve komunale. Të gjitha aktivitetet janë publikuar në faqen zyrtare të Komunës së Deçanit dhe në rrjetet sociale, me qëllim të informimit të vazhdueshëm të qytetarëve.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe janë publikuar:

- Vendimet e Kryetarit të Komunës;
- Vendimet e Kuvendit Komunal;
- Rregulloret komunale;
- Konkurset publike;
- Projektet komunale;
- Njoftimet për qytetarët;
- Njoftimet për prokurimin publik;
- Njoftimet për dhënien dhe hyrjen në fuqi të kontratave;

- Shkresa dhe dokumente të tjera me interes publik.

Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me të gjitha mediat lokale dhe qendrore, duke i informuar rregullisht ato për aktivitetet e Komunës së Deçanit dhe duke mundësuar një pasqyrim korrekt dhe objektiv të punës së institucionit.

**Aktivitete të Zyrës për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun sipas muajve:**

**Janar:**

- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal.
- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve për mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komitetit për Komunitete.
- Pjesëmarrje dhe publikim i mbledhjes së Komitetit për Komunitete.
- Pjesëmarrje në të gjitha mbledhjet e Kryetarit të Komunës me drejtorët komunalë.
- Pjesëmarrje në të gjitha takimet zyrtare të Kryetarit të Komunës, z. Bashkim Ramosaj, si brenda objektit të komunës ashtu edhe në terren.
- Përcjellje fotografike dhe mediale e aktiviteteve komunale.
- Publikimi i të gjitha vendimeve, njoftimeve dhe aktiviteteve në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale.

**Shkurt:**

- Pjesëmarrje dhe publikim i mbledhjes së Kuvendit të Komunës.
- Pjesëmarrje dhe publikim i mbledhjes së KPF-së.
- Pjesëmarrje dhe publikim i mbledhjes së Komitetit për Komunitete.
- Njoftim dhe publikim i mbledhjes së Bordit të Drejtorëve.
- Përcjellje dhe publikim i aktiviteteve të organizuara për nder të 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.
- Përcjellje fotografike dhe raportim mediatik i aktiviteteve komunale.

**Mars:**

- Pjesëmarrje dhe publikim i mbledhjes së Kuvendit të Komunës.
- Pjesëmarrje dhe publikim i mbledhjes së KPF-së.
- Pjesëmarrje dhe informim për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve.
- Dalje në terren për realizimin e fotografive dhe dokumentimin e aktiviteteve komunale.
- Pjesëmarrje në homazhet e organizuara së bashku me Kryetarin e Komunës, z. Bashkim Ramosaj.
- Pjesëmarrje dhe publikim i aktiviteteve në kuadër të manifestimit “Epopeja e Dukagjinit”, më 24 mars.
- Informim i vazhdueshëm për aktivitetet institucionale.

**Prill:**

- Pjesëmarrje dhe publikim i mbledhjes së Kuvendit të Komunës.
- Pjesëmarrje dhe publikim i mbledhjes së KPF-së.
- Pjesëmarrje në mbledhjen e Komitetit për Komunitete.
- Pjesëmarrje dhe informim për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve.
- Përcjellje në terren e aktiviteteve komunale dhe realizim fotografish.
- Publikimi i të gjitha vendimeve dhe aktiviteteve të Kryetarit të Komunës gjatë muajit.
- Informim i vazhdueshëm për projektet dhe aktivitetet komunale.

**Maj:**

Muaji maj u karakterizua me aktivitete të shumta institucionale dhe përkujtimore.

Aktiviteti më i rëndësishëm ishte organizimi dhe përcjellja mediatike e homazheve dhe ceremonive përkujtimore për nder të **5 dhe 6 Majit – Ditës së Dëshmorëve**, aktivitet që për institucionin tonë paraqet një nga ngjarjet më të rëndësishme përkujtimore të vitit.

Gjithashtu janë realizuar:

- Pjesëmarrje dhe publikim i mbledhjes së Kuvendit të Komunës.
- Pjesëmarrje dhe publikim i mbledhjes së KPF-së.
- Pjesëmarrje në mbledhjen e Komitetit për Komunitete.
- Pjesëmarrje dhe publikim i mbledhjes së KKSB-së.
- Pjesëmarrje së bashku me Kryetarin e Komunës në ceremoninë e diplomimit të maturantëve të Gjimnazit "Vëllezërit Frashëri".
- Përcjellje fotografike dhe mediale e aktiviteteve komunale.

**Qershor:**

Gjatë muajit qershor Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun ka përcjellë dhe publikuar një numër të madh aktivitetesh institucionale dhe kulturore.

Aktivitetet kryesore ishin:

- Pjesëmarrje dhe publikim i mbledhjes së Kuvendit të Komunës.
- Pjesëmarrje dhe publikim i mbledhjes së KPF-së.
- Pjesëmarrje në mbledhjen e Komitetit për Komunitete.

- Organizimi dhe përcjellja mediatike e aktiviteteve për shënimin e **16 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Deçanit**, në praninë e Kryetarit të Komunës, z. Bashkim Ramosaj.
- Pjesëmarrje dhe publikim i festivalit **“Eshkë e Ndezur mbi Shkëlzen”**.
- Pjesëmarrje në promovimin e librit dhe ekspozitës së piktorit deçanas **Ukë Lataj**.
- Pjesëmarrje në homazhe dhe aktivitete të tjera institucionale, kulturore dhe përkujtimore.
- Përcjellje fotografike, raportim mediatik dhe publikim i të gjitha aktiviteteve në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale.

## ➢ Zyra e Prokurimit

### KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN

***RAPORTI VJETOR PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE***

***Konform nenit 87.2.12 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092***

Data e përgatitjes së raportit: 23.6.2026. Viti fiskal: 2026

| PJESA I . IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES | | | |
|---|---|---|---|
| Emri zyrtar i Autoritetit Kontraktues | KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN | | |
| Lloji i Autoritetit Kontraktues | Qeveritar | Kompani Publike | Tjetër |
| Kodi buxhetor | 631 | | |
| Adresa | MENTOR TOLAJ | | |
| Kodi postar - Qyteti | 51000 | | |
| Tel. fiks/ Celulari /Faksi | | | |
| Emri i menaxherit të prokurimit | UD ASIM CENAJ | | |
| E-mail adresa | prokurimi.decan@rks-gov.net | | |
| Adresa e webit të AK | | | |

| PJESA II .KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Lloji i Buxhetit | Nr. i Prokurimit | | Afati kohor për | Kriteret për |

| Të Hyra Vetanake (1) ose Buxh.i Kons.i Kosovës (2) ose | Numri rendor i prokurimit | Lloji i prokurimit | Vlera e prokurimit | Vlera e prokurimit | Klasifikimi (2 shifrat e para të FPP) | Titulli i aktivitetit të prokurimit | Data e inicimit të aktivitetit të prokurimit | Data e publikimit të njoftimit për kontratë | Data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës | Data e nënshkrimit të kontratës ( ne rast anulimi data e njoftimit | Afatet për implementimin e kontratës (shkruaj daten e fillimit dhe të | Data e përmbylljes së kontratës ( data e pranimit të | Vlera e parashikuar e kontratës | Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj. | Çmimi i Aneks kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj. | Zbritjet nga kontrata për shkak të ndalesave | Çmimi total i paguar për kontratën | Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata | OE vendor (1) ; Jo vendor (2) | Numri i kërkesave për DT dhe numri i ofertave të dorëzuara | Numri i ofertave të refuzuara (shkruaj vetëm ato me çmimin më të | pranimin tenderëve<br>Afati kohor normal (1) Afati kohor i shkurtuar (2) | dhënie kontratës<br>Çmimi më i ulët (1) Tenderi ekonomikisht më i favorshëm (2) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 |
| | 631-26-1798-1-2-1 | 1 | 2 | 1 | 33 | Furnizim me medikamente për shtëpine e komuniteteve | 30.3.2026. | 1.4.2026. | 19.5.2026. | 18.5.2026. | | | 10.100,00 | 372,32 | | | | MEDPLUS SH.P.K. | 1 | 10 | | 1 | 1 |
| | 631-26-1923-5-2-5 | 5 | 2 | 5 | 45 | Ndërtimi i 4 urave që qon në Roshkodol dhe parkut në Isniq-Komuna e Deçanit-PUNË SHTESË | 3.4.2026. | | 21.4.2026. | 20.4.2026. | | | 17.200,00 | 17.200,00 | | | | DENISI SH.P.K. | 1 | 1 | | | 1 |
| | 631-26-2310-1-3-6 | 1 | 3 | 6 | 28 | Furnizim me kurora dhe lule për manifestime të ndryshme | 15.4.2026. | 17.4.2026. | 6.5.2026. | 4.5.2026. | | | 7.000,00 | 6.580,00 | | | | Elinda Gjikokaj B.I. | 1 | 4 | | | 1 |
| | 631-26-2598-2-2-1 | 2 | 2 | 1 | 93 | Mirëmbajtja e ndriçimit publik dhe institucioneve publike në Deçan | 26.3.2026. | 24.4.2026. | 3.6.2026. | 1.6.2026. | | | 124.000,00 | 2.370,01 | | | | ELEKTROMONT DI SH.P.K. | 1 | 16 | | 1 | 1 |
| | 631-26-2955-2-2-1 | 2 | 2 | 1 | 73 | Vlerësimi i Riskut dhe Sigurisë në Punë për Punëtorët e K.K Deçan dhe NPL"Higjiena" | 30.4.2026. | 1.5.2026. | 16.6.2026. | 12.6.2026. | | | 35.000,00 | 13.100,00 | | | | N.N. Bli TERM | 1 | 11 | | 1 | 1 |
| | 631-26-3489-2-3-6 | 2 | 3 | 6 | 93 | Shërbime me tenda dhe karrika për manifestime | 14.5.2026. | 15.5.2026. | 4.6.2026. | 2.6.2026. | | | 9.999,00 | 9.715,00 | | | | Bledi Group SH.P.K. | 1 | 7 | | | 1 |
| | 631-26-4710-1-4-7 | 1 | 4 | 7 | 25 | Furnizim me material hixhienik për shtëpine e komuniteteve ne Deçan | 15.6.2026. | | 19.6.2026. | 17.6.2026. | | | 999,00 | 964,55 | | | | NDERTIMI GROUP SH.P.K. | 1 | | | | 1 |

## ➢ Zyra e Auditorit të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm është pjesë e Administratës së Komunës së Deçanit në kuadër të zyrës së Kryetarit, pra NJAB i ushtron kompetencat e veta në përputhje me Ligjin nr. 06/L-121 për Kontroll të Brendshëm të Financave Publike.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në përmbushjen e detyrave të saj është llogaridhënës ndaj Kryetarit të Komunës, Komitetit të Auditimit dhe Njësisë Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Transfereve.

Qëllimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm është të ofroi shërbime të pavarura, objektive, siguruese dhe këshillëdhënëse te dizajnuara që të shtoj vlerën dhe të përmirësoj operacionet e organizatës. Ai ndihmon organizatën që të arrijë objektivat e saja duke sjell një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

Drejtori i NJAB-ës dhe Auditori i Brendshëm kanë përgjegjësinë që të:

Dorëzoj Planin Strategjik dhe Vjetor të Auditimit të Brendshëm tek NJQHAB-ja, jo më vonë se deri më 31 dhjetor të secilit vit kalendarik pas miratimit nga menaxhmenti i lartë (Kryetari i Komunës) dhe komiteti i Auditimit. Duke u bazuar në planin vjetor për vitin 2026 të NJAB-së, për gjashtëmujorin e parë kanë qenë të planifikuara 2 (dy) auditime të rregullta dhe të gjitha janë realizuar. Gjithashtu, është përpiluar raporti për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, i cili është dorëzuar te Kryetari i Komunës dhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese – Ministria e Financave dhe Transfereve. Sa i përket Komitetit të Auditimit, janë mbajtur dy takime të rregullta, nga të cilat janë nxjerrë rekomandime për menaxhmentin e Komunës.

| **Përgatitja dhe zbatimi i planit vjetor të auditimit të brendshëm** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.23 Gjithsej numri i auditimeve të planifikuara me plan vjetor sipas periudhave raportuese dhe realizimi i tij (për të cilat janë përpiluar raportet finale) | | | | | | |
| **Periudha raportuese** | **Numri i auditimeve të planifikuara** | **Ditët e planifikuara për kryerjen e auditimit** | **Numri i auditorëve të planifikuar për angazhim** | **Numri i auditimeve të kryera** | **Koha e shpenzuar për kryerjen e auditimit** | **Numri i auditorëve të angazhuar për auditim** |
| Gjashtëmujori I | 2 | 60 | 2 | 2 | 54 | 2 |
| Gjashtëmujori II | | | | | | |
| **Vjetore** | 2 | 60 | 2 | 2 | 54 | 2 |

| **Numri i rekomandimeve në raportet e auditimit/planet e veprimit dhe numri i rekomandimeve të zbatuara në periudhën raportuese:** | |
|---|---|
| 3.34 Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit: | **16** |
| 3.35 Numri i rekomandimeve të zbatuara: | 8 |
| 3.36 Numri i rekomandimeve në proces: | 3 |
| 3.37 Numri i rekomandimeve të pazbatuara: | 5 |
| Nëse ekzistojnë rekomandime të pazbatuara, theksohen arsyet e moszbatimit si vijon: Moszbatimi i rekomandimeve të lartcekura është rezultat i faktit se disa prej tyre kërkojnë kohë për implementim. Përveç kësaj, është vërejtur vështirësi në përcjelljen e zbatimit të tyre, pasi asnjëra nga njësitë e audituara nuk ka përpiluar planin e implementimit të rekomandimeve. | |
| **Të gjitha auditimet e kryera në periudhën raportuese janë:** | |
| **1.** Të arkëtueshmet – Drejtoria për Buxhet dhe Financa | |
| **2.** Menaxhimi i pasurisë jo financiare - Drejtoria për Buxhet dhe Financa | |

**Vlen të theksohet** se jemi në proces të auditimit të performancës për të hyrat vetanake.

Ky raport është duke u përgatitur me qëllim të vlerësimit të performancës në realizimin e të hyrave vetanake gjatë periudhës raportuese. Raporti do të paraqesë analizën e të dhënave financiare, nivelin e arkëtimit të të hyrave në raport me planifikimin e bërë, si dhe trendet e inkasimit të tyre, krahasuar me periudhat paraprake. Përmes këtij vlerësimi synohet të sigurohet një pasqyrë e qartë mbi efikasitetin e proceseve të inkasimit të të hyrave dhe menaxhimin e burimeve financiare në dispozicion.

Analiza e performancës fokusohet në identifikimin e faktorëve që kanë ndikuar pozitivisht ose negativisht në realizimin e të hyrave vetanake, duke përfshirë ndryshimet në aktivitetet ekonomike, nivelin e shfrytëzimit të shërbimeve, si dhe masat administrative të ndërmarra për rritjen e arkëtimit. Gjithashtu, raporti evidenton sfidat e hasura gjatë periudhës raportuese dhe ndikimin e tyre në përmbushjen e objektivave të përcaktuara.

Përveç paraqitjes së rezultateve të arritura, raporti do të ofrojë edhe rekomandime për përmirësimin e mëtejmë të performancës, forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe rritjen e efikasitetit në inkasimin e të hyrave vetanake. Në këtë mënyrë, raporti do të shërbejë si një instrument i rëndësishëm për vendimmarrje, planifikim dhe menaxhim më të mirë financiar, duke kontribuar në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe përmbushjen e objektivave institucionale.

## ➢ Zyra për Komunitete dhe Kthim

Zyra për Komunitete dhe Kthim në Deçan, funksionin e vetë të punës e kryen në harmoni dhe në përputhje me dispozitat ligjore, në harmoni me rregulloret e pushtetit qendror dhe atë të pushtetit lokal.

**Aktivitete të Zyrës për Komunitete dhe Kthim sipas muajve:**

**JANAR**

- Raport për MAPL-në: Obligimet e Komunave nga Agjenda Evropiane Plani Gjithëpërfshirës i Komunave Janar-Dhjetorë 2025.
- Aktiviteteve të ndryshme të zyrës për Integrime Evropiane Komunitete dhe Kthim rreth çështjeve/kërkesave të komuniteteve:
- Ndihme rreth plotësimit të dokumenteve për grante subvencione dhe ndihma të ndryshme për qytetaret e komunitetit jo shumicë.
- Kompletimi i dokumentacionit për personat e riatdhesuar në pajisje me dokumente personale, akomodim, ushqim, aftësim profesional, dhe ndihma financiare.
- Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve te përditshme nga Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Integrime Evropiane ne tekstin e mëtutjeshëm ZKK dhe IE.

**SHKURT**

- U mbajt mbledhja e parë e rregullt e Komitetit për Komunitete më 13.02.2026.
- Mbledhja konstituive e Komitetit për Komunitete për mandatin katër vjeçare.
- Aktiviteteve të ndryshme të zyrës për Integrime Evropiane Komunitete dhe Kthim rreth çështjeve/kërkesave të komuniteteve: ndihme rreth pajisjes me dokumente personale te komuniteteve.
- Ndihme rreth plotësimit të dokumenteve për grante subvencione dhe ndihma të ndryshme për qytetaret e komunitetit jo shumicë.
- Kompletimi i dokumentacionit për personat e riatdhesuar në pajisje me dokumente personale, akomodim, ushqim, aftësim profesional, dhe ndihma financiare.
- Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve te përditshme nga Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Integrime Evropiane ne tekstin e mëtutjeshëm ZKK dhe IE.

**MARS**

- U mbajt mbledhja e dytë e rregullt e Komitetit për Komunitete më 13.03.2026.
- Me datën 15 shkurt u shënua festa e Komunitetit të Ashkalinjëve.
- Informim nga zyra për Integrime Evropiane për Komunitete dhe Kthim para Komitetit për Komunitete rreth punës dhe aktiviteteve brenda vitit paraprak 2025.
- Aprovimi i planit të punës për vitin 2026.
- Aktiviteteve të ndryshme të zyrës për Integrime Evropiane Komunitete dhe Kthim rreth çështjeve/kërkesave të komuniteteve: ndihme rreth pajisjes me dokumente personale te komuniteteve.
- Ndihme rreth plotësimit të dokumenteve për grante subvencione dhe ndihma të ndryshme për qytetaret e komunitetit jo shumicë.
- Kompletimi i dokumentacionit për personat e riatdhesuar në pajisje me dokumente personale, akomodim, ushqim, aftësim profesional, dhe ndihma financiare.
- Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve te përditshme të ZKK dhe IE.

**PRILL**

- U mbajt mbledhja e tretë e rregullt e Komitetit për Komunitete më 16.04.2026.
- Takimin informues me Drejtorin e Qendrës për Punë Sociale për numrin e rasteve sociale nga komunitetet Ashkali, Egjiptianë, Malazez, Boshnjakë, Serbë dhe Rrome.
- Aktiviteteve të ndryshme të zyrës për Integrime Evropiane Komunitete dhe Kthim rreth çështjeve/kërkesave të komuniteteve: ndihme rreth pajisjes me dokumente personale te komuniteteve.
- Ndihme rreth plotësimit të dokumenteve për grante subvencione dhe ndihma të ndryshme për qytetaret e komunitetit jo shumicë.
- Kompletimi i dokumentacionit për personat e riatdhesuar në pajisje me dokumente personale, akomodim, ushqim, aftësim profesional, dhe ndihma financiare.
- Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve te përditshme të ZKK dhe IE.

**MAJ**

- U mbajt mbledhja e katër e rregullt e Komitetit për Komunitete më 08.05.2026.
- Takime në teren me drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme ku i ndjekin mësimet nxënësit e komunitetit jo shumicë ku u njoftuam për se afërmi si po zhvillohet procesi mësimor tek këto klasa me komunitete.
- Me datën 8 prill u shënua festa e Komunitetit Rom.
- Aktiviteteve të ndryshme të zyrës për Integrime Evropiane Komunitete dhe Kthim rreth çështjeve/kërkesave të komuniteteve: ndihme rreth pajisjes me dokumente personale te komuniteteve.
- Ndihmë rreth plotësimit të dokumenteve për grante subvencione dhe ndihma të ndryshme për qytetaret e komunitetit jo shumicë.

- Kompletimi i dokumentacionit për personat e riatdhesuar në pajisje me dokumente personale,  akomodim, ushqim, aftësim profesional, dhe ndihma financiare.
- Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve te përditshme të ZKK dhe IE.

**QERSHOR**

- U mbajt mbledhja e pestë e rregullt e Komitetit për Komunitete më 12.06.2026.
- Takim me drejtorin e DKA-së rreth gjendjes aktuale me vijueshmërinë e nxënësve te komunitetit jo shumicë në shkolla.
- Aktiviteteve të ndryshme të zyrës për Integrime Evropiane Komunitete dhe Kthim rreth  çështjeve/kërkesave të komuniteteve: ndihme rreth pajisjes me dokumente personale te komuniteteve.
- Ndihme rreth plotësimit të dokumenteve për grante subvencione dhe ndihma të ndryshme për qytetaret e komunitetit jo shumicë.
- Kompletimi i dokumentacionit për personat e riatdhesuar në pajisje me dokumente personale,  akomodim, ushqim, aftësim profesional, dhe ndihma financiare.
- Shkëmbim i Email-eve me qendër rreth punëve dhe angazhimeve te përditshme të ZKK dhe IE.

## ➢ Drejtoria për Administratë

Duke u bazuar në planifikimet vjetore dhe përgjegjësitë që ushtron Drejtoria për Administratë, rezulton se gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 janë përmbushur me sukses të gjitha obligimet në shërbim të qytetarëve.

- Gjatë periudhës gjashtëmujore, në Qendrën për Shërbim me Qytetarë janë pranuar dhe administruar për trajtim në departamente të ndryshme **12,699** lëndë dhe kërkesa të ndryshme.
- Zyrat e Gjendjes Civile kanë lëshuar **15,866** certifikata të ndryshme, prej të cilave **11,119** për përdorim të brendshëm dhe **4,747** për përdorim jashtë vendit.
- Zyra Ligjore ka administruar **270** lëndë të ndryshme, si në vijim:
    - Aktvendime për korrigjim – **191**;
    - Aktvendime për ndërrim të emrit dhe mbiemrit – **18**;
    - Vendime për fitimin e shtetësisë – **18**;
    - Vendime për rifitimin e shtetësisë – **36**;
    - Vendime për humbjen e shtetësisë – **7**.
- Zyra për Administrimin e E-Pasurisë dhe FreeBalance ka përpunuar **591** raporte të pranimit të mallrave.
- Zyra për kompletimin dhe lëshimin e dëshmisë së vdekjes, gjatë kësaj periudhe, ka lëshuar **117** dëshmi të vdekjes.

- Sipas raportit të Zyrës për Përkthim dhe Lekturë, bazuar në dispozitat ligjore dhe në përputhje me rregulloret e pushtetit qendror dhe lokal, përveç përkthimeve, kjo zyrë është angazhuar edhe në çështjet që lidhen me agjendën e integrimeve evropiane dhe Planin Gjithëpërfshirës të Komunës.
- Në raport janë të specifikuara angazhimet e kësaj zyre muaj pas muaji. Janë realizuar përkthimet e konkurseve, kompletimi i dokumentacionit për personat e riatdhesuar, si dhe është ofruar mbështetje për akomodimin, aftësimin profesional dhe ndihmën financiare të tyre.
- Zyra për Përkthim ka marrë pjesë në të gjitha takimet e Komitetit për Komunitete, duke ofruar shërbime të përkthimit.
- Raportit me shkrim i bashkëngjitet edhe raporti i detajuar i kësaj zyre, ku paraqiten angazhimet muaj pas muaji.
- Zyra për Teknologji Informative ka mirëmbajtur të gjitha programet aplikative që funksionojnë në Komunën e Deçanit, përfshirë:
    - Programet e administratës komunale;
    - Programet e arsimit dhe të gjitha shkollave;
    - Programet e QKMF-së;
    - Ofrimin e mbështetjes profesionale për stafin e QPS-së.
- Përgjegjësi për mirëmbajtjen e objektit është kujdesur për funksionimin e gjeneratorit në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike, për sanimin e avarive të ndryshme brenda objektit të komunës, si dhe për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra përreth objekteve komunale.
- Gjatë kësaj periudhe nuk është evidentuar asnjë rast i dyshuar apo i raportuar i korrupsionit.
- Është bërë planifikimi dhe racionalizimi i shfrytëzimit të pushimeve vjetore, në mënyrë që të mos ketë ndërprerje apo vonesa në ofrimin e shërbimeve gjatë periudhës së ardhjes së bashkatdhetarëve për pushime.

## ➢ Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit

Puna në drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit bazohet në Ligjin Për Ndërtim 04/L-110, Ligji Nr.03/L-025 Për Mbrojtjen E Mjedisit, Ligji Nr.05 L-31 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr. 06/L-024 Për Trajtimin E Ndërtimeve Pa Leje dhe aktet nën ligjore që rrjedhin prej tyre dhe në rregulloret komunale.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Deçanit ka zhvilluar një aktivitet intensiv institucional, duke realizuar takime të natyrave të ndryshme me rëndësi të veçantë për zhvillimin e komunës. Në këtë periudhë u angazhuam në hartimin dhe zbatimin e projekteve strategjike, monitorimin e punimeve në terren, bashkëpunimin me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të rëndësishme që krijojnë bazë për zhvillim të qëndrueshëm. Përmes këtyre aktiviteteve synuam të avancojmë planifikimin hapësinor, zhvillimin e turizmit, përmirësimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve më të mira të jetesës për qytetarët e Komunës së Deçanit.

Në bashkëpunim me zyrën e kryetarit, drejtoritë e tjera komunale, nivelin qendror qeverisës dhe agjencitë e ndryshme mendojmë se kemi arritur të përmbushim planin e punës së këtij gjysmë vjetori.

| Aktiviteti | Periudha | Sektori | Numri | Të tjera |
|---|---|---|---|---|
| Kërkesa dhe lende te ndryshme sipas librit te protokollit | Janar – Qershor | Drejtoria | 232 gjithsej | Te shqyrtuara 222 |
| Kryerja e punëve rreth dhënies së kushteve të lokacionit, për ndërtimet e objekteve të reja, adaptimet, rekonstruimet, rindërtimet etj. | Janar – Qershor | Sektori i urbanizmit | 6 kërkesa për kushte ndërtimi dhe njoftime publike | |
| Kërkesa për leje ndërtimi | Janar - Qershor | Sektori i planifikimit | 6 | 6 kërkesa për leje ndërtimi |
| Kërkesa për leje ndërtimi te shqyrtuara | Janar - Qershor | Sektori i planifikimit | 6 | |
| Kryerja e punëve rreth dhënies së lejes së ndërtimit dhe llogaritja e taksave urbanistike | Janar - Qershor | Sektori i urbanizmit | 6 leje<br>6 taksa | Taksa te mbledhura 48,260.22 Euro |
| Vendime për leje ndërtimi | Janar - Qershor | Sektori i planifikimit | 6 | |
| Kërkesa për leje mjedisore komunal | Janar - Qershor | Sektori për mbrojtje te mjedisit | 9 | |
| Kërkesa për leje mjedisore komunal te shqyrtuara | | | 7 | |
| Vendime për leje mjedisore komunal<br>Llogaritja e taksave mjedisore | Janar - Qershor | Sektori për mbrojtje te mjedisit | 7<br>7 taksa | Taksa te mbledhura 22,772.91 Euro |
| Numri i objekteve qe janë te pajisura me leje mjedisore komunale | Janar - Qershor | Sektori për mbrojtje te mjedisit | 7 | |
| Numri i objekteve qe janë te pajisura me leje mjedisore komunale dhe e zbatojnë lejen mjedisore komunale | Janar - Qershor | Sektori për mbrojtje te mjedisit | 7<br>7 | Është bere inspektimi ne terren ne 7 lokacionet |
| Aktivitete te planifikuara nga fusha e mjedisit | Janar - Qershor | Drejtoria ne bashkëpunim me drejtoritë e tjera | 2 aktivitete | Aktivitete qe janë ne kryer gjate vitit, janë ne planin e punës 2025 dhe ne PLVM 2023-2028 |
| Aktivitete te realizuara nga fusha e mjedisit | Janar - Qershor | Drejtoria ne bashkëpunim me drejtoritë e tjera | 2 aktivitete | Aktivitete qe janë ne kryer gjate vitit, janë ne planin e punës 2025 dhe ne PLVM 2023-2028 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Kërkesa për leje rrënimi | Janar - Qershor | Sektori i urbanizmit | 1 kërkesa<br>1 taksa | 1 vendim për leje rrënimi |
| Kërkesa për leje legalizimi | Janar - Qershor | Sektori i urbanizmit | 20 kërkesa | |
| Vendime për dhënien e certifikatës se legalizimit<br>Vendime për vendosje ne listë te pritjes<br>Mospranim dhe kthim i lendes mbrapa me mundësi ri aplikimi | Janar - Qershor | Sektori i urbanizmit | 17 vendime<br><br>1 vendim<br><br>2 kthim lende | |
| Vendime për refuzim për kushte,<br>leje ndërtimi<br>rritje etazhiteti<br>leje mjedisore dhe<br>rrënimi | Janar - Qershor | Sektori i urbanizmit, sektori i mjedisit | 4<br>2<br>5<br>0<br>0 | |
| Kërkesa për leje përdorimi | Janar - Qershor | Sektori i urbanizmit, | 2 | |
| Vendime për leje përdorimi | Janar - Qershor | Sektori i urbanizmit, | 2 | |
| Pëlqime te natyrave te ndryshme | Janar - Qershor | Zyrtarja për leje ndërtimi | 2 | |
| Njoftime te natyrave te ndryshme | Janar - Qershor | Zyrtarja për leje ndërtimi | 31 | |
| Përgjigje te natyrave te ndryshme | Janar - Qershor | Zyrtarja për leje ndërtimi | 3 | |
| Referenca për pune te kryera | Janar - Qershor | Drejtoria | 3 | |
| Puna në komisione vlerësuese për projekte të ndryshme në zyrën e prokurimit | Janar - Qershor | Drejtoria | | |
| Punimi i paramasave dhe parallogarive për projekte të ndryshme ku investitor është komuna ose niveli qendror | Janar - Qershor | Drejtoria | | |
| Komisione te pranimeve teknike të projekteve ku investitor është Komuna dhe Ministria. | Janar - Qershor | Drejtoria | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Përpilimin i kërkesave dhe akteve përcjellëse për: Ministritë, Ndërmarrje, Korporata, Agjencinë të ndryshme për nxjerrjen e buxheteve dhe përkrahjeve ligjore për projekte të ndryshme, drejtori paralele | Janar - Qershor | Drejtori | 3 kërkesa/akte | |
| Pritja e palëve, shqyrtimi i kërkesave dhe kthimi i përgjigjeve | Janar - Qershor | Drejtoria | | |

## SEKTORI I ADRESAVE

Përditësimi i numrave në sistemin elektronik të adresave është kryer në vitin 2023.
Gjatë gjysmë vjetorit të dytë të vitit 2024, ka filluar programi për deklarimin e adresës së banorëve, dhe prej janarit deri në qershor 2026 janë dhënë rreth 1,565 certifikata të vendbanimit, sipas kërkesave të palëve.

## PROJEKTI PËR BANIM SOCIAL ADEKUAT

Në kuadër të këtij projekti do të përfitojnë familjet në nevojë përmes tri nënprojekteve: ndërtimit të objektit të ri me banesa, rindërtimit dhe renovimit të shtëpive. Drejtoria, në bashkëpunim me drejtoritë e tjera komunale dhe përmes Njësisë për Implementimin e Projektit (NJIP), ka punuar në implementimin e këtyre tri nënprojekteve.

Gjatë periudhës janar – qershor 2026 janë realizuar këto aktivitete:

- 03 shkurt 2026 – Pjesëmarrje në trajnimin "Përdorimi i Aplikacionit për Mbledhjen e të Dhënave Hapësinore për Banim Social dhe të Përballueshëm", organizuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), në partneritet me UN-Habitat Kosova, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për përdorimin e aplikacionit dhe menaxhimin e të dhënave për banimin social.
- 06 mars 2026 – Është përfunduar procesi i legalizimit të 23 objekteve në kuadër të Programit të Banimit Social, duke mundësuar rregullimin e statusit juridik të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 27 mars 2026 – Është mbajtur takim me ekipin e WBIF IPF-11 – Asistencës Teknike dhe Njësinë për Implementimin e Projektit (NJIP) në Komunën e Deçanit, ku është diskutuar progresi i projektit dhe aktivitetet e mëtejshme të implementimit.
- 14 maj 2026 – Pjesëmarrje në takimin informues të organizuar në kuadër të Projektit të Banimit Social Adekuat në Kosovë, në bashkëpunim me Asistencën Teknike WBIF IPF-11 dhe Njësinë për Menaxhimin e Projektit.

- 15 maj 2026 – Është bërë dorëzimi i të gjitha dosjeve brenda afatit të përcaktuar në kuadër të procesit të përzgjedhjes së përfituesve për renovim dhe rindërtim në Programin e Banimit Social Adekuat (PBSA).
- 12 qershor 2026 – Komuna e Deçanit ka shpallur 23 përfituesit për renovim dhe rindërtim në kuadër të Programit të Banimit Social Adekuat, pas përfundimit të procedurave të vlerësimit të aplikacioneve.
- 25 qershor 2026 – Është mbajtur takim pune me ekipin e WBIF IPF-11 – Asistencës Teknike në Komunën e Deçanit, ku është shqyrtuar progresi i projektit, janë diskutuar sfidat e hasura dhe janë përcaktuar hapat e mëtejshëm për zbatimin e aktiviteteve.

Statistikat e aktiviteteve (janar – qershor 2026)

- Gjithsej aktivitete të realizuara: 7;
- Takime dhe trajnime të realizuara: 4, prej tyre:
  - 1 trajnim;
  - 3 takime pune;
- Janë legalizuar 23 objekte në kuadër të Programit të Banimit Social;
- Është miratuar lista e përfituesve, si dhe lista e aplikantëve që mbeten në listën e pritjes;
- Janë shpallur 23 përfitues për renovim dhe rindërtim;
- Është përfunduar procesi administrativ i dorëzimit të të gjitha dosjeve brenda afatit të përcaktuar;
- Është përgatitur Njësia për Implementimin e Projektit (NJIP) për fillimin e zbatimit të aktiviteteve në terren.

## SEKTORI I PLANIFIKIMIT

### Hartimi i Hartës Zonale të Komunës

- Është përgatitur drafti i Hartës Zonale të Komunës (HZK), ndërsa njëkohësisht po punohet në përgatitjen e pjesës grafike dhe hartave përkatëse.
- Është hartuar **Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)** për Hartën Zonale të Komunës. Aktualisht është në proces konsultimi publik, i cili zhvillohet për një periudhë prej **30 ditësh**, nga **08.06.2026** deri më **08.07.2026**.

- Është mbajtur debat publik me qytetarët dhe palët e interesit, gjatë të cilit ekipi punues ka prezantuar **Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)**, duke ofruar sqarime dhe duke pranuar komentet dhe sugjerimet e pjesëmarrësve.

Paralelisht me aktivitetet e tjera, Drejtoria e Urbanizmit u angazhua intensivisht në hartimin dhe kompletimin e draftit të parë të Hartës Zonale të Komunës së Deçanit. Si pjesë e këtij procesi, më 22 qershor 2026 u organizua Debati Publik për Draft Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM), dokument shoqërues i Hartës Zonale. Debati u zhvillua me pjesëmarrjen e institucioneve, organizatave dhe qytetarëve, të cilët dhanë kontributin e tyre përmes komenteve dhe rekomandimeve.

## SEKTORI I NDËRTIMIT - MENAXHIMI I KONTRATAVE

***Ndërtimi dhe rikonstruimi i lapidareve te dëshmorëve***




**25 mars 2026 – Vizita e studentëve dhe profesorëve nga TU Wien dhe UBT**

Komuna e Deçanit pati kënaqësinë të mirëpresë për dy ditë studentët e nivelit Master nga Universiteti Teknik i Vjenës (TU Wien) dhe studentët e Fakultetit të Arkitekturës të UBT-së. Së bashku me Dekanin Prof. Thomas Dillinger dhe Dekanin e Arkitekturës në UBT, Prof. Binak Beqaj, u zhvillua një takim ku u prezantua vizioni i Komunës së Deçanit për zhvillimin e turizmit malor. Studentët morën si detyrë semestrale hartimin e zgjidhjeve konceptuale për Bjeshkët e Nemuna, me fokus në Bjeshkët e Deçanit. Gjatë vizitës u organizua edhe një ekspeditë në terren, ku studentët u njohën nga afër me potencialin natyror, vizionin zhvillimor të komunës, si dhe me trashëgiminë kulturore përmes vizitave në kullat tradicionale shqiptare.







**30 mars 2026 – Takim me EcoPana**

Së bashku me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorin e Shërbimeve Publike pritëm përfaqësuesit e EcoPana, të cilët prezantuan projektin “Rruga e Kosovës drejt lumenjve të lirë – Inventarizimi i digave në Drinin e Bardhë”. Takimi shërbeu për shkëmbimin e `informacioneve dhe koordinimin institucional rreth mbrojtjes së burimeve ujore dhe zhvillimit të qëndrueshëm.




**18 maj 2026 – Vizitë zyrtare në Vjenë**

Me ftesë të Universitetit Teknik të Vjenës, së bashku me Kryetarin e Komunës zhvilluam një vizitë treditore në Vjenë. Gjatë kësaj vizite u prezantuan punimet konceptuale të studentëve për Bjeshkët e Nemuna, u zhvilluan diskutime profesionale me profesorët e universitetit dhe veçanërisht me Dekanin Prof. Thomas Dillinger, duke krijuar një bazë të fortë për bashkëpunim të mëtejshëm akademik dhe institucional.







**03 qershor 2026 – Memorandumi me UN-Habitat**
Në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit me UN-Habitat për hartimin e detyrës projektuese për Planin Rregullues të Hollësishëm "Porta e Turizmit Malor të Deçanit". Ky memorandum paraqet një nga arritjet më të rëndësishme të këtij gjashtëmujori dhe krijon bazën për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit malor.



**TRAJNIME**
Pjesëmarrja e të gjithë punëtorëve të drejtorisë në trajnimin për Vlerësimin e Riskut dhe Sigurinë në Punë për punëtoret e Komunës së Deçanit dhe NPL "Higjiena".

## ➢ Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftojë Kryetarin për realizimin e buxhetit komunal përfshirë buxhetin e secilës Drejtori – Program buxhetor, duke filluar prej programeve të Administratës së përgjithshme, Shëndetësisë primare, Arsim dhe Shkencë për periudhën Janar – Qershor 2026, duke përfshirë kategoritë ekonomike të paga & mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe investime kapitale.

Realizimin i të hyrave komunale-vetanake dhe strukturën e tyre sipas burimeve të tyre, në mënyre analitike, të hyrat nga gjobat e trafikut dhe të gjykatave si dhe krahasimi i tyre në raport me te njëjtën periudhë Janar – Qershor 2026.

- ❖ Prezantimi i të dhënave në këtë mënyrë mundëson:
  - Prezantimin e raportit financiar në formë transparente dhe të tërësishme,

- Shikimin e realizimit, respektivisht shpenzimin e mjeteve sipas kategorive (pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.
- Mundësin e krahasimit në mes fondit të planifikuar, të alokuar dhe të shpenzuar sipas kategorive, se a është tejkaluar-shfrytëzuar apo nuk është shfrytëzuar fondi i planifikuar, alokuar,

❖ Në këtë mënyrë nga aspekti financiar është e arsyeshme të paraqitet:

- Realizimi i të hyrave vetanake-komunale sipas burimeve,
- Shpenzimet e krijuara sipas kategorive buxhetore,

Të dhënat e poshtë shënuara, sa i përket shpenzimeve për paga, mallra dhe shërbime, shërbimeve komunale, subvencioneve, investimeve kapitale si dhe regjistrimi i të hyrave, sipas klasifikimit ekonomik janë të harmonizuara me Departamentin e Thesarit të Ministrisë për Financa dhe raportet që dalin nga SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës.

## 1. TË HYRAT VETANAKE

### 1.1. Planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake komunale

Raporti i përgatitur, mbulon gjashtë mujorin e parë të vitit fiskal 2026 dhe paraqet informatën e përcaktuar që kanë të bëjnë me realizimin dhe regjistrimin e të hyrave financiare. Më poshtë janë të paraqitura realizimet e te hyrave vetanake nëpër muaj si dhe tabelë e veçantë te realizimit të gjobave nga trafiku dhe gjobat nga gjykata për tremujorin e parë (TM1 – Janar, Shkurt, Mars), TM2 nuk është i paraqitur pasi qe nuk është dërguar ende raporti i TM2 nga thesari.

**1.2. Tabelat e realizimit detaj të të hyrave vetanake**

| *Raporti i realizimit te të hyrave financiare për periudhën Janar - Qershor*<br><br>**Te hyrat vetanake në periudha mujore dhe në total për periudhën 6 mujore** | | | |
|---|---|---|---|
| **PERSHKIMI** | **PLANIFIKIMI** | **REALIZIMI** | **DIFERNCA** |
| TE HYRAT TATIMORE | 597,175.00 | 159,557.38 | (437,617.62) |
| TE HYRAT JOTATIMORE | 371,104.00 | 212,960.31 | (158,143.69) |
| **TOTALI I THV 21** | **968,279.00** | **372,517.69** | **(595,761.31)** |

| *Raporti i realizimit te të hyrave financiare nga Gjobat ne trafik nga Policia dhe Gjobat nga gjykatat për periudhën Janar - Qershor*<br><br>**Te hyrat vetanake në periudha mujore dhe në total për periudhën 3 mujore TM2** | |
|---|---|
| **PERSHKRIMI** | **REALIZIMI** |
| TE HYRAT NGA POLICIA | 62,600.00 |
| TE HYRAT NGA GJYKATAT | 11,980.00 |
| TE HYRA NGA AGJENCIONI I PYJEVE PER KOMUNA | 9.98 |

| | |
|---|---|
| **TOTALI I THV INDIREKTE** | **74,598.98** |

| | |
|---|---|
| **Totali i thV (21)+ Gjobat** | **447,116.67** |

### 1.3.Paraqitja tabelare e periudhës së realizimit të të hyrave vetanake krahasuar me vitin 2025-2026

Fig.1. Krahasimi i të hyrave vetanake për periudhën Janar – Qershor 2025, Janar - Qershor 2026




Fig.1 Krahasimi i të hyrave vetanake të vitit 2026 për periudhën Janar - Qershor me te hyrat vetanake të vitit 2025 Janar - Qershor.

## 2. PLANIFIKIMI DHE SHPENZIMI I BUXHETI PËR VITIN 2006

### 2.1. Raport për periudhën Janar – Qershor 2026

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2026, Komuna e Deçanit ka menaxhuar buxhetin në përputhje me ligjet dhe rregulloret buxhetore, duke siguruar planifikim të kujdesshëm dhe shpenzim të rregullt të mjeteve publike.

#### 2.1.1. Planifikimi i Buxhetit për vitin 2027

Drejtoria për Buxhet dhe Financa gjatë muajit **qershor 2026** ka filluar procesin e planifikimit të buxhetit për vitin **2027**. Pas pranimit të **Qarkores së Parë Buxhetore 2027/1**, me datë **15.05.2026**, janë iniciuar takimet buxhetore për hartimin e **Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027–2029**.

#### 2.1.2. Shpenzimi i Buxhetit për vitin 2026

Buxheti fillestar i aprovuar nga Kuvendi Komunal për vitin 2026 ka qenë në shumën prej **14,784,180.22 €** nga **Granti Qeveritar**, si dhe **968,279.00 €** nga **Të Hyrat Vetanaake**, të planifikuara për inkasim gjatë vitit 2026.

**TABELA 1 : PLANIFIKIMI I BUXHETIT 2026 DHE SHPENZIMIMI NË TOTAL SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE**

| PERSHKRIMI | PLANIFIKIMI | REALIZIMI | DIFERENCA |
|---|---|---|---|
| Paga | 8,445,561.00 | 4,826,080.63 | (3,619,480.37) |
| Mallra | 2,216,174.54 | 1,251,816.09 | (964,358.45) |
| Komunali | 300,000.00 | 250,033.83 | (49,966.17) |
| Subvencione | 350,000.00 | 195,000.00 | (155,000.00) |
| Kapitale | 3,472,444.68 | 2,194,055.24 | (1,278,389.44) |
| TOTALI | **14,784,180.22** | **8,716,985.79** | **(6,067,194.43)** |

**TABELA 2 : PLANIFIKIMI I BUXHETIT 2026 DHE SHPENZIMIMI SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE**

| PERSHKRIMI | BUXHETI FINAL | SHPENZIMI | DIFERENCA |
|---|---|---|---|
| **GRANT QEVERITAR (10)** | **13,583,695.00** | **8,432,093.42** | **(5,151,601.58)** |
| PAGAT DHE SHTESAT | 8,445,561.00 | **4,826,080.63** | (3,619,480.37) |
| MALLRA DHE SHERBIME | 1,641,721.00 | **1,036,663.70** | (605,057.30) |
| SHPENZIME KOMUNALE | 300,000.00 | **250,033.83** | (49,966.17) |
| SUBVENCIONE DHE TRANSFERE | 290,000.00 | **190,000.00** | (100,000.00) |
| INVESTIMET KAPITALE | 2,906,413.00 | **2,129,315.26** | (777,097.74) |
| **TE HYRA VETANAKE (21)** | **968,279.00** | **284,892.37** | **(683,386.63)** |
| MALLRA DHE SHERBIME | 358,279.00 | **215,152.39** | (143,126.61) |
| SUBVENCIONE DHE TRANSFERE | 60,000.00 | **5,000.00** | (55,000.00) |
| INVESTIMET KAPITALE | 550,000.00 | **64,739.98** | (485,260.02) |
| **TE HYRA VETANAKE (22)** | **215,152.39** | **-** | **(215,152.39)** |
| MALLRA DHE SHERBIME | **215,152.39** | - | (215,152.39) |
| SUBVENCIONE DHE TRANSFERE | - | - | - |
| INVESTIMET KAPITALE | - | - | - |
| **GRANT I DONAT.TË BRENDSHËM (31)** | **16,027.70** | **-** | **(16,027.70)** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| MALLRA DHE SHERBIME | 4.00 | - | (4.00) |
| INVESTIMET KAPITALE | 16,023.70 | - | (16,023.70) |
| **GRANTE TJERA TË JASHTME (32)** | **974.50** | **-** | **(974.50)** |
| MALLRA DHE SHERBIME | 974.50 | - | (974.50) |
| **QEVERIA NORVEGJEZE (57)** | **7.98** | **-** | **(7.98)** |
| INVESTIMET KAPITALE | 7.98 | - | (7.98) |
| **QEVERIA JAPONEZE (59)** | **-** | **-** | **-** |
| INVESTIMET KAPITALE | - | - | - |
| **COUNCIL OF EUROPE (93)** | **43.65** | **-** | **(43.65)** |
| MALLRA DHE SHERBIME | 43.65 | - | (43.65) |
| **TOTALI :GRANTI + THV+DONACIONET** | **14,784,180.22** | **8,716,985.79** | **(6,067,194.43)** |

**Tabela 3. RAPORTI I SHPENZIMEVE PER PERIUDHEN JANAR-QERSHOR 2026 SIPAS KATEGORIVE EKONOMIKE**

| Përshkrim | Shuma |
|---|---|
| **Valutë: EURO** | |
| 631 - GP+THV | 15,018,096.59 |
| 11 - PAGA DHE SHTESA | 4,826,080.63 |
| 13 - MALLRA DHE SHËRBIME | 1,251,816.09 |
| 14 - SHPENZIME KOMUNALE | 250,033.83 |
| 20 - SUBVENCIONE DHE TRANSFERE | 195,000.00 |
| 30 - PASURITË JOFINANCIARE | 2,194,055.24 |

| | |
|---|---|
| **Bilanci i përgjithshëm** | 8,716,985.79 |

*Tabela 3.1* **RAPORTI I SHPENZIMEVE PER PERIUDHEN JANAR-QERSHOR 2026 SIPAS FONDIT BURIMOR DHE KATEGORIVE EKONOMIKE**

| **Përshkrim** | **shuma** |
|---|---|
| **Valutë** **euro** | |
| 10 - BUXHETI | 5,082,426.84 |
| 11 - PAGA DHE SHTESA | 4,826,080.63 |
| 13 - MALLRA DHE SHËRBIME | 1,036,663.70 |
| 14 - SHPENZIME KOMUNALE | 250,033.83 |
| 20 - SUBVENCIONE DHE TRANSFERE | 190,000.00 |
| 30 - PASURITË JOFINANCIARE | 2,129,315.26 |
| 21 - TË HYRAT VETANAKE | **2,569,349.09** |
| 13 - MALLRA DHE SHËRBIME | 215,152.39 |
| 20 - SUBVENCIONE DHE TRANSFERE | 5,000.00 |
| 30 - PASURITË JOFINANCIARE | 64,739.98 |
| **Bilanci i përgjithshëm** | **284,892.37** |

## 3. PAGESAT NË ARKË

### 3.1. Raport për periudhën janar – Qershor 2026

Pagesat në arkë gjatë periudhës Janar – Qershor **2026** janë realizuar për shërbime dhe taksa administrative me vlerë **nën 10 euro**, në përputhje me rregulloret financiare në fuqi. Këto pagesa kanë përfshirë shërbime të ndryshme administrative, si: certifikata të lindjes dhe ekstrakte të lindjes, certifikata të vendbanimit, certifikata të vdekjes, certifikata të statusit martesor, certifikata të martesës, certifikata të bashkësisë familjare, certifikata të shtetësisë, vërtetime nga arkiva, si dhe taksa të tjera administrative.

Gjatë periudhës **janar–qershor 2026**, sipas raporteve zyrtare të arkës, janë evidentuar të dhënat financiare si në vijim: janë lëshuar fletëpagesa në vlerë totale prej **4.302 €**, ndërsa vlera e pagesave të anuluara ka qenë **105 €**. Mjetet financiare të grumbulluara dhe të dorëzuara në arkën kryesore kanë arritur shumën prej **15,297 €**.

| | |
|---|---|
| Raport i fletëpagesave të lëshuara | **4302€** |
| Raport i pagesave te anuluara | **105€** |
| Mjetet e dorëzuara ne arkën kryesore | **15,297€** |
| Mjetet e dorëzuara ne arkë sipas kodit Ekonomik | **R.S. 4,893€ - E.L. 9,105 € - G.K. 183-€ - S.D.1,112€** |

Gjatë gjithë periudhës raportuese, në çdo ditë pune është realizuar barazimi i arkës në orët e mëngjesit, ndërsa në orët e pasdites është bërë zbrazja e arkës dhe dorëzimi i mjeteve financiare në postë, duke respektuar plotësisht procedurat dhe standardet financiare.

| *Vendosja e viktimave të dhunës në familje në Shtëpinë e sigurt "Safe House" Gjakovë* | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 |

*Gjithsej 495 shërbime sociale të përfunduara në gjashtë mujorin e parë në periudhën Janar – Qershor 2026*

***Raporti i punës për gjashtë mujorin e parë për vitin 2026 të shërbimeve të Asistencës Sociale (Janar-Qershor)***

| ***Llojet e Shërbimeve*** | **JANAR** | **SHKURT** | **MARS** | **PRILL** | **MAJ** | **QERSHOR** | **TOTAL** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Kërkesa të reja për Nd.S.kat.I-rë* | 0 | 1 | 1 | 0 | 2 | 0 | 4 |
| *Kërkesa te reja për Nd.S.kat.II-të* | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | 2 |
| *Kërkesa të Aprovuara nga Komisioni Mjek.* | 18 | 35 | 15 | 19 | 19 | 22 | 128 |
| *Riaplikime te kat. së I-rë* | 15 | 28 | 17 | 9 | 25 | 19 | 113 |
| *Riaplikime te kat se II-të* | 11 | 15 | 9 | 9 | 20 | 12 | 76 |
| *Ndërprerja e Ndihmave Sociale* | 0 | 2 | 3 | 1 | 2 | 1 | 9 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Kërkesa te refuzuara nga K.Mjekësor* | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| *Ankesa për DMS* | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| *Ankesa për Gj. Supreme* | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| *Vërtetime për Student* | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| *Autorizime* | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| *Riaktivizime* | 0 | 0 | 3 | 1 | 2 | 3 | 9 |
| *Vazhdimi i Kartonëve për Ndihma Sociale* | 26 | 43 | 26 | 18 | 45 | 31 | 189 |
| *Vizita në Familje* | 28 | 50 | 27 | 24 | 48 | 39 | 216 |
| *Ndihma e njëhershme* | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| *Numri i Familjeve ne A.Sociale* | 277 | 271 | 265 | 263 | 262 | 256 | 256 |
| *Tereni-Verifikimi i Kërkesave te reja* | 0 | 1 | 2 | 1 | 2 | 0 | 6 |
| *Vërtetime qe nuk merr Ndihma Sociale* | 2 | 0 | 1 | 1 | 0 | 2 | 5 |

*Gjithsej 1013 shërbime të Asistencës Sociale të përfunduara në gjashtë mujorin e parë në periudhën Janar – Qershor 2026.*

***SHTËPIA E KOMUNITETIT***

Shtëpia e Komunitetit në Deçan ofron:

- Shërbime për personat më aftësi të kufizuara mendore
- Mbështetje për përmirësimin e mirëqenies se komunitetit përmes programeve shëndetësore, edukative dhe sociale.

Meqenëse një numër i caktuar i personave kanë nevojë për një përkujdesje të vazhdueshme nga institucionet, aktualisht në Shtëpinë e Komunitetit në Deçan janë 10 pacientë, të cilët kanë përkujdesje të vazhdueshme nga stafi mjekësorë dhe stafi përcjellës:

- Infermierët
- Neuropsikiatri
- Psikologjia
- Sigurimi

Kërkesat për vendosjen e rezidentëve shqyrtohen nga Komisioni i përzgjedhur, sipas
**UA** për punën dhe kriteret për vendosjen e rezidenteve, personave me aftësi të kufizuara mendore.

- **Aktivitetet e realizuara në Shtëpinë e Komunitetit (SHK)**

- ✓ Përkujdesja mjekësore.
- ✓ Pranimi i rezidenteve të rinjë (që përzgjidhen nga DSHMS ne bashkëpunim me Dr. Nysret Pepaj, Neuropsikiatër dhe komisionin e përzgjedhur, në bazë të shkallës së retardimit).
- ✓ Bashkëpunimi me familjarët e rezidenteve, dhe takimet pacient-familjar.
- ✓ Mirëmbajtja dhe Renovimi i objektit.
- ✓ Monitorimi i punës së Shtëpisë së Komunitetit.

- **Shërbimet e ofruara ndaj pacientëve**

  - ✓ Përkujdesja nga stafi i SHK ndaj rezidentëve
  - ✓ Shërbimet infermierore
  - ✓ Shërbimet Laboratorike
  - ✓ Kontrolle nga specialist të ndryshëm (duke e përcjellur gjendjen shëndetësore rregullisht)
  - ✓ Vizitë nga Neuropsikiatri

- ✓ Vizitë nga Psikologu Klinik
- ✓ Sigurimi i branave të nevojshme
- ✓ Sigurimi i veshmbathjeve

## ➢ Drejtoria për Arsim

Gjatë periudhës janar–qershor 2026, Drejtoria Komunale e Arsimit në Deçan ka ushtruar kompetencat dhe përgjegjësitë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke siguruar mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor në të gjitha institucionet parauniversitare të komunës.

Përmes këtij raporti paraqiten aktivitetet kryesore të realizuara gjatë periudhës raportuese, me qëllim të informimit transparent mbi punën, organizimin dhe zhvillimin e politikave arsimore në Komunën e Deçanit.

Procesi mësimor është monitoruar vazhdimisht nga Drejtoria Komunale e Arsimit përmes vizitave të rregullta në institucionet arsimore nga Drejtori i Arsimit dhe zyrtarët përgjegjës. Gjatë këtyre vizitave është vlerësuar ecuria e procesit mësimor, janë identifikuar nevojat e institucioneve dhe është ofruar mbështetje profesionale për stafin drejtues dhe mësimdhënës.

Po ashtu, janë mbajtur takime të rregullta koordinuese me drejtorët e institucioneve arsimore, ku janë trajtuar çështje që lidhen me organizimin e procesit mësimor, zbatimin e legjislacionit, zhvillimin profesional dhe përgatitjen e aktiviteteve të ndryshme.

Në vazhdimësi është zhvilluar bashkëpunim i ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, duke realizuar me kohë të gjitha obligimet dhe detyrat e përcaktuara nga ministria.

### 1. STRUKTURA ORGANIZATIVE

Drejtoria Komunale e Arsimit përbëhet nga shtatë (7) zyrtarë:

- Drejtori i Arsimit;
- Udhëheqësi i Sektorit Administrativ;
- Udhëheqësi i Sektorit për Arsim;
- Përgjegjësja për Buxhet dhe Financa;
- Zyrtari për Arsimin e Mesëm të Lartë;
- Zyrtari Ligjor;
- Zyrtari për Arsimin Fillor.

## 2. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME PËR ARSIMIN

Në administrimin e Drejtorisë Komunale të Arsimit janë:

- 20 objekte të arsimit parauniversitar;
- 1 institucion parashkollor publik dhe 1 institucion privat;
- 1 institucion i ri parashkollor publik në ndërtim, në hapësirat e SHFMU "Lidhja e Prizrenit";
- 18 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta;
- 2 shkolla të mesme të larta (Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri" dhe IAAP "Tafil Kasumaj").

Në institucionet arsimore janë të angazhuar gjithsej **567 punonjës**, prej tyre:

- 427 mësimdhënës;
- 33 punonjës administrativë;
- 85 punonjës teknikë;
- stafi tjetër sipas strukturës organizative.

Procesin mësimor e ndjekin rreth **4,100 nxënës**.

## 3. GJENDJA E INFRASTRUKTURËS ARSIMORE

- 20 institucione arsimore janë të rrethuara.
- 19 institucione janë të pajisura me sistem të kamerave të sigurisë.
- 17 institucione kanë masa për kursimin e energjisë.
- Asnjë institucion nuk është i pajisur me sistem të energjisë solare.
- Asnjë institucion nuk është i pajisur me sistem gjeotermal.
- 18 institucione kanë kabinete funksionale të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK).
- 15 institucione kanë bibliotekë funksionale.
- 10 institucione kanë sallë të edukatës fizike të pajisur me mjetet e nevojshme.
- 6 institucione kanë laboratorë dhe kabinete profesionale.
- Në SHFMU "Lidhja e Prizrenit" funksionon një klasë e bashkangjitur e pajisur me inventarin e nevojshëm shkollor.

## 4. AKTIVITETET E REALIZUARA

### JANAR 2026

#### Planifikimi i vendeve të punës për vitin shkollor 2026/2027

Gjatë muajit janar, Drejtoria Komunale e Arsimit filloi përgatitjet për planifikimin e vendeve të punës për vitin shkollor 2026/2027, duke analizuar nevojat e institucioneve arsimore dhe strukturën organizative të personelit mësimor dhe administrativ.

Më **05.01.2026** u realizuan ndryshimet në listën e pagave, në përputhje me nevojat organizative dhe dispozitat ligjore në fuqi.

#### Donacione për pajisjen e kabineteve të Teknologjisë Informative

Më **13.01.2026**, Drejtoria Komunale e Arsimit realizoi shpërndarjen e pajisjeve teknologjike në disa institucione arsimore, me qëllim përmirësimin e kushteve për zhvillimin e procesit mësimor.

U pajisën:

- SHFMU **"Ardhmëria"** në Beleg me **9 kompjuterë**;
- Gjimnazi **"Vëllezërit Frashëri"** me **17 kompjuterë**;
- SHFMU **"Lidhja e Prizrenit"** në Deçan me:
  - 40 kompjuterë;
  - 25 Smart TV;
  - 35 tabela shkollore;
  - 316 banka shkollore;
  - 400 ulëse;
  - inventar tjetër të nevojshëm për zhvillimin e procesit mësimor.

Ky investim ndikoi drejtpërdrejt në modernizimin e infrastrukturës shkollore dhe krijimin e kushteve më cilësore për mësimdhënie dhe mësimnxënie.

#### Përkujtimi i Masakrës së Reçakut

Më **15.01.2026**, në të gjitha institucionet arsimore të Komunës së Deçanit, ora e parë mësimore iu kushtua përkujtimit të Masakrës së Reçakut.

Nxënësit dhe mësimdhënësit zhvilluan aktivitete përkujtimore, diskutime dhe punime tematike, duke nderuar viktimat dhe duke kultivuar vlerat historike e qytetare tek brezat e rinj.

**Garat Komunale të Fizikës**

Më **18.01.2026**, në bashkëpunim me Shoqatën Kosovare të Fizikës, u organizuan Garat Komunale të Fizikës.

Garat u mbajtën në ambientet e Gjimnazit **"Vëllezërit Frashëri"**, me pjesëmarrjen e **120 nxënësve** të klasave VII–XII nga të gjitha shkollat e komunës.

Nxënësit fitues u kualifikuan për pjesëmarrje në Garat Shtetërore të Fizikës, të organizuara nga Departamenti i Fizikës në Universitetin e Prishtinës.

**Shpallja e rezultateve të Garës Komunale të Fizikës**

Më **19.01.2026** u publikuan rezultatet e Garës Komunale të Fizikës.

Rezultatet dëshmuan nivel të lartë të përgatitjes së nxënësve dhe angazhimin profesional të mësimdhënësve të lëndës së fizikës.

**Menaxhimi i incidentit në SHFMU "Sylejman Vokshi"**

Më **20.01.2026**, rreth orës 02:00, Drejtoria Komunale e Arsimit u njoftua për një incident zjarri në SHFMU **"Sylejman Vokshi"**.

Zjarri kishte përfshirë depot e druve për ngrohje, ndërsa ndërhyrja e njësive të zjarrfikësve bëri të mundur lokalizimin dhe shuarjen e tij.

Rasti iu raportua menjëherë Policisë së Kosovës, e cila filloi procedurat hetimore për përcaktimin e shkakut të zjarrit.

Drejtoria monitoroi situatën dhe ndërmori masat e nevojshme për vazhdimin normal të procesit mësimor.

**Olimpiada Matematike e Kosovës**

Më **22.01.2026** u publikuan rezultatet preliminare të Olimpiadës Matematike të Kosovës.

Nxënësit e Komunës së Deçanit arritën rezultate të mira, duke dëshmuar përgatitje cilësore dhe nivel të lartë të njohurive në matematikë.

**Hulumtimi për ushqyeshmërinë në shkolla**

Më **28.01.2026**, në bazë të rekomandimit të MASHTI-t, Drejtoria Komunale e Arsimit bashkëpunoi me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe UNICEF-in për realizimin e hulumtimit mbi ushqyeshmërinë në shkolla.

Në këtë proces u përfshinë:

- IAAP **"Tafil Kasumaj"**;
- SHFMU **"Faik Konica"** në Ratishë.

Hulumtimi u realizua përmes anketave me nxënësit dhe drejtuesit e shkollave, me qëllim mbledhjen e të dhënave për përmirësimin e politikave shëndetësore në institucionet arsimore.

**Garat Shtetërore të Fizikës**

Më **31.01.2026** u publikuan rezultatet përfundimtare të Garave të XXVII-ta Shtetërore të Fizikës.

Nxënësit fitues të vendeve të para, të dyta dhe të treta në klasat X, XI dhe XII siguruan pjesëmarrjen në Olimpiadën Kosovare të Fizikës, duke përfaqësuar me sukses Komunën e Deçanit.

**SHKURT 2026**

**Takim me përfaqësuesit e KFOR-it (LMT)**

Më **04.02.2026**, Drejtoria Komunale e Arsimit zhvilloi një takim pune me Shefin e Ekipit Ndërlidhës dhe Monitorues (LMT) për Deçan, z. **Marshall Giovanni Martorelli**, dhe bashkëpunëtorët e tij.

Gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin ndërinstitucional dhe mbështetjen që KFOR-i ofron për institucionet arsimore të komunës. Palët shprehën gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit në projekte që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe sigurisë në shkolla.

**Organizimi i Garës Komunale "Spelling Bee 2026"**

Më **05.02.2026**, Drejtoria Komunale e Arsimit, në bashkëpunim me Grupin PEMA, organizoi Garën Komunale **"Spelling Bee 2026"**.

Në këtë aktivitet morën pjesë rreth **90 nxënës** nga institucionet arsimore të Komunës së Deçanit, të cilët demonstruan njohuritë dhe aftësitë e tyre në gjuhën angleze.

Organizimi i kësaj gare synon nxitjen e mësimit të gjuhëve të huaja, zhvillimin e kompetencave gjuhësore dhe promovimin e konkurrencës së shëndetshme ndërmjet nxënësve.

**Kompletimi i kabinetit të Teknologjisë Informative**

Gjatë muajit shkurt përfundoi kompletimi dhe funksionalizimi i kabinetit të Teknologjisë Informative në SHFMU **"Lidhja e Prizrenit"** në Deçan.

Në funksion u vendosën mbi **30 kompjuterë**, duke krijuar kushte më të mira për zhvillimin e mësimit bashkëkohor dhe avancimin e aftësive digjitale të nxënësve.

Ky investim paraqet një hap të rëndësishëm drejt digjitalizimit të procesit mësimor në komunë.

**Punëtoritë "Promovimi i Vlerave Humane"**

Në IAAP **"Tafil Kasumaj"** u organizuan tri punëtori me temën **"Promovimi i Vlerave Humane"**, të realizuara nga diseminatorët PhD Cand. Fjolla Cacaj dhe MSc. Eridë Ferizaj.

Punëtoritë u mirëpritën nga nxënësit dhe trajtuan tema që lidhen me:

- përgjegjësinë qytetare;
- solidaritetin;
- humanizmin;
- vullnetarizmin.

Pas përfundimit të trajnimeve, nxënësit filluan realizimin e aktiviteteve konkrete në komunitet, duke zbatuar në praktikë njohuritë e fituara.

**Tryeza për zhvillimin e arsimit**

Më **14.02.2026**, përfaqësues të Drejtorisë Komunale të Arsimit morën pjesë në një tryezë të organizuar në Komunën e Istogut nga Kolegji Heimerer.

Diskutimet u fokusuan në:

- bashkëpunimin ndërmjet arsimit parauniversitar dhe arsimit të lartë;
- mbështetjen e nxënësve të talentuar;

- aplikimin e praktikave bashkëkohore në arsim;
- zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Përfaqësuesit e DKA-së kontribuuan me propozime konkrete për forcimin e bashkëpunimit institucional dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit.

**Shënimi i 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës**

Me rastin e **18-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës**, më **16.02.2026**, në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Deçanit u organizuan aktivitete përkujtimore, kulturore dhe sportive.

Programet përfshinë:

- recitime;
- këngë patriotike;
- valle tradicionale;
- pjesë teatrore;
- ekspozita artistike;
- ese dhe vizatime me temë atdhetare.

Gjithashtu u organizuan gara sportive në:

- futboll;
- volejboll;
- pingpong;
- disiplina të tjera sportive.

Këto aktivitete kontribuuan në kultivimin e vlerave qytetare, identitetit kombëtar dhe frymës së bashkëpunimit ndërmjet nxënësve.

**Punimet në ndërtimin e çerdhes publike**

Më **26.02.2026**, Drejtoria monitoroi ecurinë e punimeve në ndërtimin e çerdhes publike në Deçan.

Punimet vazhduan me intensitet të lartë dhe sipas planit dinamik.

Ky projekt pritet të krijojë kushte moderne për edukimin dhe kujdesin e fëmijëve të moshës parashkollore, duke zgjeruar kapacitetet publike të edukimit të hershëm në komunë.



**Sukses në Olimpiadën Ndërkombëtare të Matematikës STEM**

Më **27.02.2026**, nxënëset e Komunës së Deçanit arritën rezultate të jashtëzakonshme në Olimpiadën Ndërkombëtare të Matematikës STEM.

Rezultatet:

- **Vlera Himaj** – Medalje e Artë (Gold Medal);
- **Dea Himaj** – Medalje e Argjendtë (Silver Medal).

Të dyja nxënëset siguruan pjesëmarrjen në finalen ndërkombëtare (**Grand Final**) që do të mbahet në Romë, Itali.

Ky sukses përfaqëson një arritje të rëndësishme për arsimin e Komunës së Deçanit dhe dëshmon cilësinë e punës së mësimdhënësve dhe përkushtimin e nxënësve.

**MARS 2026**

**Sukses në Techathon 2026**

Më **01.03.2026**, nxënësit e Gjimnazit **"Vëllezërit Frashëri"** morën pjesë në edicionin e parë të **Techathon – Teens AI Kosovo 2026**, ku konkurruan ekipe nga e gjithë Kosova.

Ekipi i gjimnazit fitoi **vendin e parë** me projektin **"Lodestar"**, një mentor virtual i bazuar në inteligjencën artificiale, i krijuar për të ndihmuar nxënësit në orientimin në karrierë. Projekti u zhvillua në kuadër të objektivit **"Quality Education (SDG 4)"** dhe u vlerësua për inovacionin, funksionalitetin dhe ndikimin e tij në procesin edukativ.

Ky sukses dëshmon potencialin dhe kreativitetin e të rinjve të Komunës së Deçanit në fushën e teknologjisë dhe inovacionit.

**Projekti "Drejt Malit" – Mësimi i skijimit**

Po më **01.03.2026**, nxënësit e SHFMU **"Lidhja e Prizrenit"** morën pjesë në projektin edukativo-sportiv **"Drejt Malit"**, i cili kishte për qëllim promovimin e sporteve dimërore dhe zhvillimin e aftësive fizike të nxënësve.

Përveç mësimit praktik të skijimit, u organizuan edhe aktivitete edukative dhe rekreative, si gara në shah dhe aktivitete ekipore, të cilat kontribuan në zhvillimin e frymës së bashkëpunimit, përgjegjësisë dhe socializimit të nxënësve.

**Aktivitet sensibilizues kundër dhunës**

Më **02.03.2026**, IAAP **"Tafil Kasumaj"** organizoi një aktivitet sensibilizues kundër të gjitha formave të dhunës.

Në kuadër të këtij aktiviteti u realizua një demonstrim profesional mjekësor dhe një aksion humanitar, ku mjetet e mbledhura iu dedikuan bamirësisë.

Aktiviteti u ndoq edhe nga përfaqësues të KFOR-it dhe qytetarë të shumtë, duke përcjellë mesazhe për paqe, solidaritet dhe respekt reciprok.

**Përkujtimi i Epopesë së UÇK-së**

Më **05.03.2026**, në të gjitha institucionet arsimore të Komunës së Deçanit, ora e parë mësimore iu kushtua përkujtimit të **Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës**, në nderim të datave 5, 6 dhe 7 Mars.

Përmes orëve tematike, prezantimeve dhe diskutimeve, nxënësit u njohën me historinë dhe sakrificën e familjes Jashari dhe të gjithë atyre që kontribuuan për lirinë e Kosovës.

**Shënimi i 7 Marsit – Ditës së Mësuesit**

Më **07.03.2026**, Drejtoria Komunale e Arsimit organizoi ceremoninë tradicionale për shënimin e **Ditës së Mësuesit**.

Në këtë aktivitet u ndanë:

- mirënjohje për mësimdhënësit dhe punonjësit arsimorë të pensionuar;
- certifikata për pjesëmarrësit në trajnimet e organizuara nga DKA në bashkëpunim me Institutin Pedagogjik të Kosovës.

Aktiviteti kishte për qëllim vlerësimin e kontributit shumëvjeçar të mësimdhënësve dhe promovimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional.

**Takim pune me drejtorët e institucioneve arsimore**

Më **18.03.2026**, Drejtoria Komunale e Arsimit mbajti takim koordinues me drejtorët e institucioneve edukativo-arsimore.

Gjatë takimit u trajtuan këto çështje:

- analiza e ecurisë së procesit mësimor gjatë periudhës së parë të gjysmëvjetorit të dytë;
- organizimi i aktiviteteve për shënimin e 24 Marsit – Epopesë së Dukagjinit;
- gjendja e infrastrukturës shkollore;
- nevojat për mjete konkretizuese dhe mirëmbajtje të objekteve.

Takimi shërbeu për koordinimin e veprimeve të përbashkëta dhe planifikimin e aktiviteteve të ardhshme.

**Ekspozita përkujtimore për 24 Marsin**

Më **23.03.2026**, u organizua ekspozita e punimeve artistike të nxënësve të shkollave fillore të Komunës së Deçanit, kushtuar shënimit të **24 Marsit – Epopesë së Dukagjinit**.

Ekspozita u shoqërua me një program artistik, ku nxënësit prezantuan krijime dhe interpretime që pasqyronin historinë, sakrificën dhe vlerat kombëtare.

Në këtë aktivitet morën pjesë edhe nxënës nga Komuna e Hanit të Elezit, duke forcuar bashkëpunimin ndërkomunal në fushën e arsimit dhe kulturës.

**Vizita e delegacionit nga Komuna e Beratit**

Më **31.03.2026**, Drejtoria Komunale e Arsimit mirëpriti një delegacion nga Komuna e Beratit, i përbërë nga mësimdhënës dhe nxënës të Shkollës Profesionale **"Kristo Isak"**.

Vizita u realizua në bashkëpunim me IAAP **"Tafil Kasumaj"**, me synim:

- shkëmbimin e përvojave profesionale;
- prezantimin e praktikave të mira në arsimin profesional;
- forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet dy komunave.

Takimi shënoi një hap të rëndësishëm drejt zgjerimit të partneriteteve në fushën e arsimit profesional dhe krijimit të mundësive të reja për zhvillimin e nxënësve dhe stafit mësimor.

**PRILL 2026**

**Takim me Inspektoratin e Arsimit**

Më **01.04.2026**, në ambientet e Drejtorisë Komunale të Arsimit u zhvillua një takim pune me përfaqësuesit e Sektorit të Inspektoratit të Arsimit (SIA) – Pejë.

Takimi u realizua me pjesëmarrjen e inspektorëve të arsimit dhe stafit drejtues të DKA-së, ku u diskutua për zbatimin e legjislacionit në fuqi, monitorimin e cilësisë së procesit mësimor dhe koordinimin e aktiviteteve inspektuese gjatë periudhës në vijim.

**Takim koordinues me drejtorët e shkollave**

Më **03.04.2026**, Drejtoria Komunale e Arsimit organizoi takimin e radhës me drejtorët e institucioneve edukativo-arsimore të komunës.

Në takim u diskutuan këto çështje:

- fillimi i procesit të vlerësimit të brendshëm të shkollave sipas planeve dinamike dhe udhëzimeve administrative në fuqi;
- vazhdimi i procesit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve;
- procedurat për licencimin dhe rilicencimin e mësimdhënësve;
- organizimi i trajnimeve profesionale për stafin arsimor dhe menaxherial.

Në përfundim të takimit u dakordua që takimet koordinuese të mbahen rregullisht me qëllim të monitorimit të progresit dhe adresimit të sfidave në sistemin arsimor komunal.

**Planifikimi i trajnimeve profesionale**

Më **09.04.2026**, u zhvillua një takim pune lidhur me planifikimin e trajnimeve për mësimdhënësit e Komunës së Deçanit.

Trajnimet u planifikuan në fushat:

- pedagogji;
- psikologji;
- barazi gjinore;
- përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie;
- metodologji bashkëkohore të mësimdhënies.

Gjithashtu u diskutua për forcimin e rolit të pedagogëve dhe psikologëve në institucionet arsimore, me synim përmirësimin e mbështetjes profesionale për nxënësit dhe ngritjen e cilësisë së arsimit.

**Raportim në Komitetin për Komunitete**

Më **17.04.2026**, në mbledhjen e III-të të Komitetit për Komunitete, përfaqësuesi i Drejtorisë Komunale të Arsimit prezantoi raportin mbi vijueshmërinë e nxënësve nga komunitetet joshumicë në institucionet arsimore të Komunës së Deçanit.

Raporti përfshiu:

- të dhëna statistikore mbi vijueshmërinë;
- sfidat në përfshirjen e komuniteteve joshumicë;
- masat e ndërmarra për parandalimin e braktisjes së shkollimit;
- rekomandime për rritjen e përfshirjes në procesin edukativo-arsimor.

Në takim morën pjesë edhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare UNMIK, OSBE dhe KFOR.

**Trajnim për menaxhimin e sfidave psiko-sociale**

Më **25.04.2026**, Drejtoria Komunale e Arsimit organizoi trajnimin me temën:

**"Bashkëpunimi ndërdisiplinar në menaxhimin e sfidave psiko-sociale në arsim".**

Në trajnim morën pjesë:

- drejtorë të shkollave;
- mësimdhënës;
- psikologë;
- pedagogë.

Qëllimi i aktivitetit ishte forcimi i bashkëpunimit ndërmjet profesionistëve të arsimit dhe përmirësimi i mekanizmave mbështetës për mirëqenien psiko-sociale të nxënësve.

**Olimpiada Komunale e Gjuhës Shqipe**

Po më **25.04.2026**, në ambientet e IAAP **"Tafil Kasumaj"**, u organizua faza e dytë e Olimpiadës së Gjuhës Shqipe në nivel komunal.

Në garë morën pjesë **40 nxënës**, fitues të fazës shkollore.

Pjesëmarrësit demonstruan njohuri të avancuara në gjuhën shqipe, ndërsa aktiviteti kontribuoi në promovimin e kulturës gjuhësore dhe zhvillimin e kompetencave gjuhësore të nxënësve.

**Panairi i Praktikave Profesionale**

Më **30.04.2026**, IAAP **"Tafil Kasumaj"** organizoi Panairin e Praktikave Profesionale.

Në këtë aktivitet morën pjesë nxënës të profileve:

- Informatikë;
- Mjekësi;
- Ekonomi;

- Turizëm;
- Hidroinstalues;
- Automekanikë.

Nxënësit prezantuan projektet dhe punimet e tyre praktike para përfaqësuesve të bizneseve dhe institucioneve partnere.

Panairi krijoi mundësi për:

- prezantimin e aftësive profesionale të nxënësve;
- forcimin e bashkëpunimit ndërmjet shkollës dhe bizneseve;
- zgjerimin e mundësive për praktikë profesionale dhe punësim.

Ky aktivitet përfaqëson një praktikë të mirë në lidhjen e arsimit profesional me kërkesat e tregut të punës.

**MAJ 2026**

**Takim informues për organizimin e Testit të Maturës Shtetërore**

Më **06.05.2026**, në Drejtorinë Komunale të Arsimit u zhvillua takim informues me përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit lidhur me organizimin dhe mbarëvajtjen e **Testit të Maturës Shtetërore**.

Në takim morën pjesë drejtorë të institucioneve arsimore, mësimdhënës dhe koordinatorë të procesit të maturës.

Gjatë takimit u diskutuan:

- përgatitjet organizative dhe logjistike për testimin;
- përgjegjësitë e institucioneve arsimore;
- procedurat e administrimit të testit;
- rëndësia e respektimit të rregullave dhe standardeve për garantimin e një procesi të drejtë dhe transparent.

U theksua se Testi i Maturës Shtetërore përbën një moment të rëndësishëm në rrugëtimin arsimor të maturantëve dhe kërkon bashkëpunim të plotë ndërmjet të gjitha institucioneve përgjegjëse.

**Donacion për gjelbërimin e institucioneve arsimore**

Më **06.05.2026**, në kuadër të bashkëpunimit me organizatat **Humanity First** dhe **AMJ Kosovë**, u realizua mbjellja e **60 drunjve dekorativë** në dy institucione arsimore të Komunës së Deçanit:

- SHFMU **"Sylejmon Vokshi"** – Prejlep;
- SHFMU **"Dëshmorët e Baballoqit"** – Baballoq.

Ky aktivitet kishte për qëllim përmirësimin e mjedisit shkollor, promovimin e kujdesit ndaj natyrës dhe edukimin e nxënësve për përgjegjësi ekologjike.

**Pjesëmarrje në Festivalin e Kërcimit të Tropojës**

Më **08.05.2026**, nxënësit e shkollave të Komunës së Deçanit morën pjesë në **Festivalin e Kërcimit të Tropojës**, i cili është pjesë e aktiviteteve kulturore me karakter ndërkombëtar.

Nxënësit prezantuan pika të vallëzimit tradicional, duke përcjellë me dinjitet kulturën, traditën dhe vlerat kombëtare.

Pjesëmarrja në aktivitete të tilla kulturore kontribuon në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore tek brezat e rinj.

**Olimpiada e Gjuhës Shqipe Kosovë–Shqipëri**

Më **09.05.2026**, në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë u zhvillua faza e tretë e **Olimpiadës së II-të të Gjuhës Shqipe Kosovë–Shqipëri** për nxënësit e klasave të nënta.

Komuna e Deçanit u përfaqësua nga nxënës të shkollave tona, të cilët morën pjesë në këtë garë mbarëkombëtare duke dëshmuar përgatitje të lartë në fushën e gjuhës shqipe.

Kjo olimpiadë promovon:

- ruajtjen e gjuhës shqipe;
- zhvillimin e shkathtësive gjuhësore;
- bashkëpunimin arsimor ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

**Takim pune me drejtorët e shkollave dhe Këshillin Pedagogjik-Psikologjik**

Më **20.05.2026**, Drejtoria Komunale e Arsimit organizoi dy takime të ndara pune.

**Takimi me drejtorët e shkollave**

Në këtë takim u trajtuan çështje me rëndësi për përfundimin e suksesshëm të vitit shkollor, ndër të cilat:

- vlerësimi dhe përmbyllja e periudhës së katërt të gjysmëvjetorit të dytë;
- shqyrtimi i normativit të mësimdhënësve për vitin shkollor 2026/2027;
- organizimi i mësimit zgjedhor;
- planifikimi dhe hapja e konkurseve të reja;
- çështje të tjera me rëndësi për funksionimin e shkollave.

**Takimi me Këshillin Pedagogjik-Psikologjik**

Në këtë takim u diskutua procesi i:

**Vlerësimit të fëmijëve për regjistrim në klasën e parë**, në përputhje me Udhëzimin Administrativ MASHTI 09/2023.

U përcaktuan:

- hapat proceduralë të vlerësimit;
- roli i psikologëve dhe pedagogëve;
- instrumentet profesionale që do të përdoren;
- koordinimi ndërmjet institucioneve për regjistrimin e gjeneratës së re të nxënësve.

**Garat Republikane të Shahut**

Më **21.05.2026**, në kuadër të programit **"Sporti në Shkolla"**, u zhvilluan garat republikane të shahut.

Në këtë aktivitet morën pjesë:

- 17 shkolla nga e gjithë Kosova;
- 170 nxënës pjesëmarrës.

Garat kishin për qëllim zhvillimin e mendimit strategjik, promovimin e sportit të shahut dhe edukimin e nxënësve përmes konkurrencës së ndershme.

**Vizitë e nxënësve në Komunën e Hanit të Elezit**

Më **21.05.2026**, nxënësit e SHFMU **"Lidhja e Prizrenit"** dhe IAAP **"Tafil Kasumaj"** realizuan një vizitë në Komunën e Hanit të Elezit.

Delegacioni u prit nga:

- Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit;
- Drejtoria Komunale e Arsimit;
- përfaqësues të institucioneve lokale.

Gjatë vizitës u zhvilluan aktivitete edukative dhe u vizituan vende me rëndësi historike, përfshirë Bllacën.

Nxënësit vizituan edhe SHFMU **"Iliaz Thaçi"**, ku u shkëmbyen përvoja dhe u forcua bashkëpunimi ndërmjet institucioneve arsimore.

**Olimpiada e II-të e Gjuhës Shqipe Kosovë–Shqipëri**

Më **23.05.2026**, nxënëset e SHFMU **"Lidhja e Prizrenit"**, Era Sylaj dhe Daorsa Shabanaj, përfaqësuan Komunën e Deçanit në Olimpiadën e II-të të Gjuhës Shqipe Kosovë–Shqipëri.

Pjesëmarrja në këtë garë mbarëkombëtare paraqet një arritje të rëndësishme dhe dëshmon përkushtimin e nxënësve dhe mësimdhënësve në fushën e gjuhës dhe kulturës shqiptare.

**Kolegjiumi i Drejtorëve Komunalë për Arsim**

Më **26.05.2026**, u mbajt takimi i parë i Kolegjiumit të Drejtorëve Komunalë për Arsim në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Në takim u diskutuan sfidat kryesore të arsimit parauniversitar në nivel lokal, përfshirë:

- mungesën e stafit profesional në profile të caktuara;
- ndikimin financiar të Kontratës Kolektive;
- nevojën për koordinim më të madh me MASHTI-n;
- procesin e digjitalizimit të shkollave;
- nevojën për investime të reja në sistemin arsimor.

Drejtorët Komunalë për Arsim shprehën gatishmërinë për bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet qendrore me qëllim përmirësimin e sistemit arsimor.

**Festa e Abetares**

Më **31.05.2026**, në institucionet arsimore të Komunës së Deçanit u organizua **Festa e Abetares**.

Ky aktivitet shënoi përfundimin me sukses të hapit të parë të nxënësve në rrugëtimin e tyre arsimor.

Përmes programeve kulturore dhe artistike, nxënësit prezantuan njohuritë dhe shkathtësitë e fituara gjatë vitit të parë shkollor.

**QERSHOR 2026**

**Aktivitet praktik për sistemet fotovoltaike në IAAP "Tafil Kasumaj"**

Më **01.06.2026**, në IAAP **"Tafil Kasumaj"** në Deçan u realizua aktiviteti praktik në kuadër të konceptit **Mobile Training**, i organizuar nga kompania **ELING Grup** dhe **Solarit Academy**.

Gjatë këtij aktiviteti, nxënësit patën mundësi të njihen nga afër me sistemet fotovoltaike dhe komponentët kryesorë të energjisë solare.

Përmes demonstrimit praktik, nxënësit u informuan për:

- strukturën e sistemeve fotovoltaike;
- mënyrën e instalimit;
- funksionimin e pajisjeve;
- aplikimin e teknologjive të energjisë së ripërtëritshme.

Aktiviteti u realizua në kuadër të programit **"Short Term Courses"**, i mbështetur nga projekti **"Aftësi të Qëndrueshme në Kosovë"**, i financuar nga Dukati i Madh i Luksemburgut dhe i zbatuar nga Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor – LuxDev.

Ky aktivitet kontribuon në lidhjen e arsimit profesional me zhvillimet teknologjike dhe kërkesat e tregut të punës.

**Mbledhja e Komitetit për Komunitete**

Më **15.06.2026**, u mbajt mbledhja e radhës e Komitetit për Komunitete, e udhëhequr nga Kryesuesi i Komitetit.

Në këtë takim, përfaqësuesi i Drejtorisë Komunale të Arsimit prezantoi gjendjen aktuale të institucioneve arsimore në Komunën e Deçanit, me fokus të veçantë në:

- vijueshmërinë e nxënësve;
- përfshirjen e komuniteteve në arsim;
- sfidat që lidhen me braktisjen e shkollimit;
- masat mbështetëse për sigurimin e pjesëmarrjes së rregullt në procesin edukativo-arsimor.

**Donacion librash për bibliotekat e shkollave**

Më **15.06.2026**, bibliotekat e shkollave të Komunës së Deçanit u pasuruan me një donacion të rëndësishëm librash nga autori z. **Bardhyl Mahmuti**.

Donacioni u dorëzua nga z. **Fadil Muqolli**, dhe përmban libra me vlerë historike e edukative, të cilët do t'u shërbejnë nxënësve dhe mësimdhënësve.

Ky donacion kontribuon në:

- pasurimin e fondit të bibliotekave shkollore;
- nxitjen e leximit tek nxënësit;
- ruajtjen e kujtesës historike dhe kulturore.

**Përzgjedhja e teksteve shkollore për vitin 2026/2027**

Më **29.06.2026**, bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për përzgjedhjen e teksteve shkollore për klasat 1–9, institucionet arsimore të Komunës së Deçanit filluan procesin e plotësimit të katalogëve sipas ofertave të shtëpive botuese.

Procesi u realizua në përputhje me procedurat dhe udhëzimet përkatëse, me qëllim sigurimin e teksteve të përshtatshme për nxënësit për vitin shkollor 2026/2027.

**Trajnim për sigurimin e cilësisë në shkolla**

Më **30.06.2026 dhe 01.07.2026**, u realizua trajnim dyditor për mësimdhënësit në kuadër të programit të certifikuar:

**"Modeli Kolegial i Sigurimit të Cilësisë".**

Trajnimi u organizua nga Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me organizatën **KosEd** dhe u implementua nga Instituti Pedagogjik i Kosovës.

Në grupin e parë të trajnimit morën pjesë drejtorë, pedagogë dhe mësimdhënës nga këto institucione:

- SHFMU **"Kuvendi i Verrave të Llukës"** – Llukë e Epërme;
- SHFMU **"Lan Selimi"** – Lumbardh;
- SHFMU **"Heronjtë e Dukagjinit"** – Gllogjan;
- SHFMU **"Dëshmorët e Vokshit"** – Pobërgjë;
- SHFMU **"Drita"** – Gramaçel.

Qëllimi kryesor i trajnimit ishte:

- fuqizimi i bashkëpunimit kolegial;
- ngritja e standardeve të mësimdhënies;
- përmirësimi i menaxhimit shkollor;
- krijimi i një mjedisi më cilësor për nxënësit.

## 6. REKOMANDIME

Për periudhën në vazhdim, Drejtoria Komunale e Arsimit rekomandon:

1. Vazhdimin e investimeve në infrastrukturën fizike dhe teknologjike të institucioneve arsimore.
2. Rritjen e numrit të kabineteve profesionale dhe pajisjeve bashkëkohore për mësim praktik.
3. Vazhdimin e trajnimeve profesionale për mësimdhënësit dhe stafin menaxherial.
4. Forcimin e rolit të pedagogëve dhe psikologëve shkollorë në mbështetjen e nxënësve.
5. Zgjerimin e bashkëpunimit me organizata vendore dhe ndërkombëtare për realizimin e projekteve arsimore.
6. Përmirësimin e mëtejshëm të kushteve për nxënësit me nevoja të veçanta dhe promovimin e arsimit gjithëpërfshirës.
7. Vazhdimin e promovimit të nxënësve të talentuar dhe mbështetjen e tyre në gara kombëtare dhe ndërkombëtare.
8. Forcimin e bashkëpunimit ndërmjet DKA-së, institucioneve shkollore dhe komunitetit.

- **Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural**

| **Nr.** | **Përmbajtja – Aktivitetet** | **Koha** | **Zbatuesi** | **Pjesëmarrësit** |
|---|---|---|---|---|
| **1.** | Realizimi i planit gjashtëmujor të punës së DBPZHR | Janar – Korrik | DBPZHR | DBPZHR |
| **2.** | Realizimi i projektit për pajisjet e bletarëve – organizata Mëshqerra | Qershor | *Donatori-Mëshqerra* | Mëshqerra |
| **3.** | Takime zyrtare me MBPZHR dhe ministritë të tjera, OQ dhe OJQ | Tri takime | *DBPZHR* | DBPZHR, MBPZHR dhe ministritë të tjera, OQ dhe OJQ |
| **4.** | Takime me Donatorin-OJQ-në Mëshqerra dhe Drejtorinë | Shkurt - Qershor | *DBPZHR*<br>*QIKB* | DPBZHR, MBPZHR dhe fermerët |
| **5.** | Takime me pronarët e autokombajnave për fillimin e korrje-shirjeve | Qershor | *DBPZHR* | DPBZHR |
| **6.** | Pëlqimi i kërkesave për shndërrimin e tokave bujqësore ne ato ndërtimore | Janar - Qershor | *DBPZHR*<br>*Shefi i drejtorisë* | DBPZHR dhe MBPZHR |
| **7.** | Përgatitja për fushatën e korrje-shirjeve - 2026 | Korrik | *DBPZHR*<br>*-Zyrtari me staf* | DPBZHR, MBPZHR, fermerët dhe auto kombajnerët |
| **8.** | Përcjellja e kulturave pranverore | Mars - Qershor | *DBPZHR*<br>*Zyrtari* | DPBZHR dhe fermerët |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **9.** | Grumbullimi i të dhënave, rezultateve të prodhimtarisë bujqësore | Janar - Qershor | *DBPZHR,*<br>*-Zyrtari &stafi* | DPBZHR, MBPZHR dhe fermerët |
| **10.** | Kontaktet dhe vizitat në fermat prodhuese<br>Mbi 70 vizita te fermat dhe individët | Shkurt - Qershor | *DBPZHR &stafi* | DPBZHR, MBPZHR dhe fermerët |
| **11.** | Përcjellja e programeve zhvillimore të ndryshme | Mars - Qershor | *MBPZHR-Komuna, DBPZHR*<br>*Komuna e Deçanit-Zyra e prokurimit* | MBPZHR- K. Deçanit<br>Komuna |
| **12.** | Marrëveshje bashkëpunimi-<br>KRU "DRINI I BARDHË" SH. A PEJË<br>Komuna Deçan-Drini i Bardhë | Prill | *DBPZHR* | Komuna e Deçanit |
| **13.** | Aktivitetet në Qendrën Informative Komunale të Bujqësisë<br>- 115 konsulta dhe këshilla për fermer<br>- 10 vizita në teren-pemëtore<br>- 50 vizita në stalla<br>- 30 vizita në sera | Janar - Qershor | *QIKB-këshilltari* | QIK<br>DSHK<br>Këshilltari publik i Shërbimeve Këshilluese te Kosovës |
| **14.** | Hapja e afatit për Pagesa Direkte | Qershor - Korrik | *DBPZHR, stafi* | DBPZHR & MBPZHR |
| **15.** | Ndihma për fermerët aplikues në Grante | Janar - Qershor | *DBPZHR, QIKB* | |
| **16.** | Është përpiluar raporti për mbjelljet dhe realizimin e mbjelljeve pranverore si dhe planifikimi për korrje-shirje | Maj - Qershor | *DBPZHR* | DBPZHR & MBPZHR |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **17.** | Hapja dhe mirëmbajtja e kanaleve të ujitjes në Komunën e Deçanit | Qershor - Korrik | *DBPZHR – Drini i Bardhë* | |

- **Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike**

- **SEKTORI PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM**

**Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim**, gjatë periudhës janar–qershor 2026, aktivitetin e saj të planifikuar në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit e ka realizuar duke u mbështetur në **Ligjin për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera Nr. 04/L-027**, **Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 04/L-012**, **Ligjin për Zjarrfikës dhe Shpëtim Nr. 04/L-049**, udhëzimet administrative, si dhe aktet e tjera normative që e rregullojnë këtë fushë.

**Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike**, konkretisht **Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim**, ka arritur t'i kryejë punët dhe detyrat e planifikuara lidhur me parandalimin, evitimin dhe dhënien e rekomandimeve për menaxhimin e rreziqeve të mundshme nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim është marrë gjithashtu edhe me punë dhe detyra të tjera që kanë dalë nga objektivat dhe planifikimet e drejtorisë, të përcaktuara në mënyrë periodike, ashtu siç janë paraparë në **Planin e Punës për vitin 2026**.

Raporti gjashtëmujor do të përmbajë aktivitetet dhe punët e planifikuara sipas planit vjetor, situatat emergjente, planet e reja të hartuara, si dhe dokumentet e nevojshme. Të gjitha këto do të paraqiten në formë tabelare, në baza mujore dhe vjetore.

| | **Aktivitetet** | **Periudha** |
|---|---|---|
| | Përgatitja e planeve të punës, raportin vjetor dhe dokumente tjera bazike për vitin 2026 | Dhjetor 2025 |
| | Përgatitja e Dokumentacionit (lëndëve të miratuara) për Arkivim | Janar |

| | | |
|---|---|---|
| | Gjatë muajit janar në Komunën e Deçanit ka pasur vërshime të cilat kanë shkaktuar dëme në zona të ndryshme të komunës. Menjëherë pas paraqitjes së situatës, ekipet emergjente kanë dalë në terren dhe kanë intervenuar në lokacionet ku është identifikuar rreziku për qytetarët dhe pronën.<br><br>Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve ka kryer vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet dhe ka hartuar raportin përkatës. Raporti është shqyrtuar dhe miratuar nga Kuvendi Komunal, pas së cilës i është përcjellë Komisionit Qendror për procedim të mëtejmë. | Janar |
| | Takimi i I-rë i KKSB-së | Mars |
| | Gjatë gjashtë mujorit të parë, Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike ka pranuar 211 kërkesa në Intranet ku 192 janë miratuar, 3 refuzuar, 4 anuluar, 8 pezulluar dhe 4 janë në proces. | Janar - Qershor |
| | Takimi i II-të i KKSB-së | Maj |
| | Mirëmbajtja e aparateve për shuarjen e zjarrit për të gjitha institucionet publike. | Gjatë vitit |
| | Njoftim/apel qytetareve për vetëdijesim dhe kujdes nga zjarret.<br><br>Njoftimi është bërë në formë të shkruar ku është shpërndarë në tërë territorin e Komunës së Deçanit.<br><br>Shih linkun: https://www.facebook.com/photo?fbid=1289843609818211&set=a.324214523047796 | Qershor |
| | Ka vazhduar projekti për mirëmbajtjen e rrjetit të kamerave në Komunën e Deçanit. | Janar - Qershor |
| | Në librin e protokollit të shkurtër janë evidentuar shkresa si: Akte përcjellëse, Autorizime, Ftesa për palët, Njoftime për përfundimin e procedurës ligjore, Konkluzionet, kërkesa për plotësim lënde e tjera, të cilat punë kanë qenë të pa planifikuara mirëpo janë të domosdoshme gjatë zhvillimit të procedurës ligjore. | Gjatë vitit |
| | Kryerja e punëve administrative: si përgatitja e fletë dorëzimeve, dërgimi i shkresave palëve në procedurë nëpërmjet shërbimit të postës dhe direkt në dorë, përgatitja e thirrjeve për palët në procedurë, konsultime me palët, evidentimi në regjistrat e inspektimeve e tjera. | |
| | Takime të rregullta me Policinë, KFOR-in dhe organizata tjera | Gjatë vitit |
| | Komunikim i vazhdueshme dhe bashkëpunim më QRAKE-Pejë | Gjatë vitit |

**Raport nga Inspektori për parandalim ndaj zjarrit**

| Nr. | Detyrat e realizuara | Total | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | **Zjarret** | **45** | **6** | **5** | **18** | **8** | **2** | **8** | | | | | | |
| | Raporte të zjarreve | | **2** | **1** | **2** | **1** | **1** | **/** | | | | | | |
| | Dalje ne terren për Hulumtimin e shkakut te zjarrit | | **2** | **1** | **2** | **1** | **1** | | | | | | | |
| | Vërtetime te zjarrit | | **/** | **/** | **/** | **1** | | | | | | | | |
| 2. | **Inspektimet e fillestar, rregullta, verifikuese** | | **7** | **8** | **4** | **3** | | **6** | | | | | | |
| | Nr. i te metave dhe mangësive | | **26** | **37** | **18** | **15** | | | | | | | | |
| | Insp. në pronësi shtetërore | | **/** | **/** | | | | | | | | | | |
| | Insp. në pronësi private | | ✓ | ✓ | ✓ | ✓ | | ✓ | | | | | | |
| | Numri i objekteve | | **7** | **8** | | | | | | | | | | |
| | Procesverbal | | **4** | **8** | **4** | **3** | | **6** | | | | | | |
| | Propozim te masave dhe afateve | | **4** | **8** | **4** | **3** | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Miratim i inspektimit | | 7 | / | | | | | | | | | | |
| **3.** | **Inspektime te jashtëzakonshme** | | | **8** | **4** | **3** | | | | | | | | |
| | Insp. në pronësi shtetërore | | | | | | | | | | | | | |
| | Insp. në pronësi private | | | ✓ | | | | | | | | | | |
| | Miratim i inspektimit te jashtëzakonshëm | | | **8** | **4** | **3** | | **6** | | | | | | |
| **4.** | **Vendime ne inspektime te rregullta dhe fillestare** | | **7** | **8** | **4** | **3** | | **/** | | | | | | |
| | Masat e shqiptuara | | | | | | | | | | | | | |
| **5.** | **Inspektim ne korrje shirjeve dhe maleve** | | | | | | | **5** | | | | | | |
| **6.** | **Njoftime** | | | | | | | **2** | | | | | | |
| **7.** | **Të tjera;** | | **1** | **1** | | **1** | | | | | | | | |

Raport nga njësia e zjarrfikësve - Deçan

| **REALIZIMI I NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË INTERVENIMEVE, STRUKTURA E ZJARREVE DHE INT.TJERA PËR 6 mujorin e VITIT - 2026** | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2026 | Nr.i përgj. i | Nr.i zjarreve | Nr. i intervenimeve teknike | Aksidente rrugore | Pastrim rruge | Vërshime | Të rrejsh | Të lënduar | | | Të vdekur | | |
| | | | | | | | | zj. | qyt. | tot | zj. | qyt. | tot |

| | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | daljeve | | | | | | | | | | | | |
| Janar | 12 | 6 | 6 | | | 4 | | | | | | | |
| Shkurt | 8 | 5 | 5 | | | | | | | | | | |
| Mars | 19 | 18 | 1 | | 1 | | | | | | | | |
| Prill | 9 | 8 | 1 | | | | | | | | | | |
| Maj | 8 | 2 | 6 | 3 | | | | | | | | | |
| Qershor | 13 | 8 | 5 | | | | | | | | | | |
| **Gjithsejtë** | **69** | **45** | **22** | | | | | | | | | | |

**KATEGORIZIMI I ZJARREVE DHE INTERVENIMEVE SIPAS 6 mujorit te VITIT - 2026**

| | **Lloji I INTERVENIMIT** | **Jan.** | **Shku.** | **Mar.** | **Prill** | **Maj** | **Qersh** | **Korr.** | **Gush.** | **Shta.** | **Tet.** | **Nënt.** | **Dhje.** | **GITHËSEJ** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | ZJARRE | 6 | 3 | 18 | 8 | 2 | 8 | | | | | | | **45** |
| **2** | INTERVENIME TEKNIK | 6 | 3 | 1 | 1 | 6 | 5 | | | | | | | **22** |
| **3** | SHËRBIME | 2 | | 1 | | | | | | | | | | |
| **4** | AKSIDENTE KOMUNIKACIONI | | | | | 3 | | | | | | | | |
| **5** | VËRSHIME | 4 | | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **6** | ALARME TË RREJSHME | | | | | | | | | 1 | | | | |
| | **1. Llojet e zjarreve;** | | | | | | | | | | | | | |
| 1.1 | Shtëpi banimi<br>dhe objekte përcjellëse | 1 | | 1 | 1 | | 1 | | | | | | | |
| 1.2 | Objekte kolektive (banesa) | 1 | | | | | | | | | | | | |
| 1.3 | Malore | | 2 | 6 | 4 | 1 | 1 | | | | | | | |
| 1.4 | Fushore | | | 4 | | 1 | 2 | | | | | | | |
| 1.5 | Stalla te bagëtive | | | | | | | | | | | | | |
| 1.6 | Oxhaqe | 1 | | | | | | | | | | | | |
| 1.7 | Automjete motorike/vetura | | | 1 | | | 1 | | | | | | | |
| 1.8 | Shtylla elektrike / trafo | | | 2 | 2 | | 1 | | | | | | | |
| 1.9 | Pajisjet shpërndarëse | 1 | | 4 | | | | | | | | | | |
| 1.11 | Mbeturina | | | | 1 | | 2 | | | | | | | |
| 1.12 | Operator/biznese | | | | | | | | | | | | | |
| 1.13 | Institucione publike | 2 | | 1 | | | | | | | | | | |
| | Të tjera | | | | | | | | | | | | | |

| Ndarja analitike e zjarreve në: SIPËRFAQE TË HAPURA | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.1 | | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nëntor | Dhjetor | GITHËSEJ |
| | | | | | | | | | | | | | | |
| 4.2 | Mal Sip. e djegur (hektar) | | 0.35 Ha | 16 Ha | 12.5 Ha | 5 Ha | | | | | | | | **33.85 Ha** |
| 4.3 | Fushor Sip.e djegur (hektar) | | | | | 0.30 Ha | | | | | | | | **0.30 Ha** |

- **SEKTORI PËR SHËRBIME PUBLIKE**

Sektori për Shërbime Publike në kuadër të organizimit dhe të strukturës së tij mbi punën dhe aktivitetet, është i organizuar më organogram: Shef i Sektorit të Shërbimeve Publike, Zyrtar për Ndërtim, Zyrtar për Transportin Publik, Zyrtar i Lartë për Menaxhimin e mbeturinave, që përveç detyrave të përcaktuara me përshkrimin e vendit të punës, të parapara në nenin 13 të Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Deçanit, ushtron edhe detyra dhe përgjegjësi të tjera shtesë që dalin nga veprimtaria e drejtorisë, sipas nevojës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sipas planifikimeve vjetore nga drejtoria, në Sektorin e Shërbimeve Publike, detyra parësore kanë qenë realizimi i projekteve në infrastrukturën rrugore, ndërtimi dhe mirëmbajtja e tyre, mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik, menaxhimi i mbeturinave, ndërtimi i trotuareve, shesheve, ndërtimi dhe mirëmbajtja e kanalizimit, mirëmbajtja e varrezave publike si dhe ndërtimi i lapidareve të dëshmorëve, kujdesi për hapësirat publike në tërë territorin e komunës së Deçanit, kanalizimin e qytetit dhe detyra të tjera dytësore që dalin gjatë vitit. Po ashtu pjesë e aktiviteteve është edhe bashkëpunimi me ndërmarrjet komunale dhe regjionale siç janë: Kompania N.P.L. "Higjiena", Kompania Regjionale e Ujësjellësit "Hidrodrini", Ndërmarrja Regjionale për Ujitje të tokave "Drini i Bardhë" si dhe bashkëpunimi me KEDS.

Koordinim dhe bashkërendim të punëve dhe aktiviteteve, me theks të veçantë, Sektori i Shërbimeve Publike ka pasur me NPL "Higjiena", ku shumicën e punëve të menaxhimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së hapësirave publike, mirëmbajtjen dhe rregullimin e varrezave dhe

Lapidarëve të Dëshmoreve, i ka të kontraktuara me kontratën "Në Shtëpi". I tërë ky aktivitet monitorohet në baza ditore dhe sipas nevojës, nga menaxheri i kontratës dhe zyrtari i lartë për menaxhimin e mbeturinave.

Raporti gjashtëmujor i punës, Janar- Qershor 2026 do të përfshijë në mënyrë të detajuar të gjitha të dhënat mbi punët dhe aktivitetet e kryera gjatë vitit raportues, të paraqitura në formë tabelore dhe narrative, në përputhje të plotë me planifikimin e miratuar në vitin paraprak dhe aktet normative në fuqi.

1. **<u>Infrastruktura rrugore dhe mirëmbajtja gjatë vitit 2025</u>**



### 1.1 Asfaltimi i rrugëve në territorin e Komunës së Deçanit Janar - Qershor 2026

| Nr. | Vendi dhe emri i rrugës |
|---|---|
| 1. | Mirëmbajtja Verore dhe Dimërore<br><br>(Prerja e vegjetacionit në një pjesë të territorit të komunës, sanimi dhe riasfaltimi i gropave në rrugët e komunës së Deçanit, mbushja me zhavorr dhe asfaltimi i një pjese të parkingut tek qendra Rinore, asfaltimi i rrugëve në fshatin Beleg, asfaltimi i rrugëve të lagjes së re tek "Podi i Geshtenjave" në Deçan. |
| 2. | Vazhdojnë punimet në segmentin Lëbushë-Strellc |

### 1.2 Projektet

| Nr. | Projektet | Projekt i përfunduar/ në vazhdim |
|---|---|---|
| 1. | Mirëmbajtja verore dhe dimërore | në vazhdim |
| 2. | Ndërtimi i kanalizimit në rrugën "Elena Gjika " dhe rrugëve tjera | Një pjesë e projektit ka përfunduar, vazhdon projekti edhe në fshatra tjerë. |
| 3. | Ndërtimi i rrugës Bjeshka e Madhe (Laku i Kryqës) | në vazhdim |
| 4. | Vendosja dhe mirëmbajtja e tabelave informuese, emërtimet e fshatrave, rrugëve etj. | në vazhdim |

## 2. Mirëmbajtja verore dhe dimërore

Rrugët në territorin e Komunës së Deçanit mirëmbahen rregullisht si gjatë sezonit veror ashtu edhe dimëror.

## 3. **Ujësjellësi**

Vazhdon bashkëpunimi me Kompaninë Regjionale të Ujësjellësit “Hidrodrini”.

## 4. **Mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik**

Edhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, ka vazhduar mirëmbajtja e ndriçimit publik efiçient në tërë territorin e Komunës së Deçanit.

## 5. Mirëmbajtja e kanalizimit

Komuna e Deçanit në bazë të marrëveshjes respektivisht kontratës me K.R.U “Hidrodrini” si dhe N.P.L. “Higjiena” ka bërë mirëmbajtjen e kanalizimit të ujërave të zeza, gropave septike dhe nyjave sanitare në territorin e Komunës së Deçanit, zhbllokimin e pusetave dhe pastrimi i tyre, zbrazja e gropave septike, gërmimi, furnizimi, ndërrimi i gypave deri në funksionalizimin e plotë të ujërave të zeza.

Zhbllokimi dhe pastrimi i pusetave të kanalizimit të ujërave atmosferike. Vendosja e kapakëve metalik dhe të betonit të pusetave të kanalizimit të ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike etj.

## 6. Vendosja dhe mirëmbajtja e tabelave informuese, emërtimet e fshatrave, rrugëve etj

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 ka vazhduar vendosja e tabelave të emërtimeve të vendbanimeve, tabelave informuese si dhe mirëmbajtja e tabelave të emërtimeve të rrugëve.

## 7. **Aktivitetet e Komunës bashkë me N.P.L “Higjiena” - Kontrata “Në shtëpi”**



Ndër aktivitetet kryesore që Komuna e Deçanit, konkretisht Sektori për Shërbime Publike ka pasur me Ndërmarrjen Publike Lokale "Higjiena" është mbikëqyrja dhe monitorimi i realizimit të punëve të kontraktuara sipas kontratës "Në Shtëpi".

Me poshtë do t'i paraqesim punët dhe aktivitetet e kryera në shumë fusha së bashku me N.P.L." Higjiena" si:

## 7.1 Mirëmbajtja e hapësirave publike

Komuna e Deçanit në bazë të kontratës me kompanitë e kontraktuara, ka bërë mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe të gjelbra duke përfshirë mbjelljen, ujitjen, mirëmbajtjen e mobilierisë urbane, riparimi i shtigjeve me kubëza, pastrimi dhe fshirja e rrugëve kryesore dhe trotuareve në qytet, kositja e parqeve, prerja e vegjetacionit, sanimi i gropave dhe riasfaltimi i tyre, si dhe punë me ekskavator sipas kërkesës së Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.

## 7.2 Dekorimi i qytetit për festat zyrtare dhe festa tjera

Dekorimi i qytetit për të gjitha festat zyrtare, vendosja e flamujve, ndërrimi i flamujve, vendosja e shtyllave të flamujve, dekorimi i qytetit për festat e fund vitit dhe dekorime tjera sipas kërkesës dhe nevojave nga D.M.SH.SH.P.

## 7.3 Mirëmbajtja e lapidarëve, memorialëve dhe varrezave të Dëshmorëve

Plani për mirëmbajtjen e lapidarëve, memorialëve dhe varrezave të dëshmorëve, pastrimi, mirëmbajtja e tyre, mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese përreth kompleksit të dëshmorëve, duke përfshirë prerjen dhe kositjen e barit në të gjitha fshatrat në tërë territorin e komunës.

## 8. Punë dhe aktivitete tjera sipas D.SH.P.-së

Gjatë gjashtëmujorit të parë për vitin raportues 2026 është bërë identifikimi i deponive ilegale të mbeturinave. Gjithashtu është përgatitur dhe dorëzuar raporti vjetor për Agjencionin e Mbrojtjes së Mjedisit AMMK me të gjitha të dhënat e kërkuara.

Në kuadër të kontratës trevjeçare për **"Mirëmbajtjen e kamerave të qytetit dhe institucioneve tjera"**, gjatë periudhës **janar–qershor 2026** janë realizuar aktivitetet e planifikuara për mirëmbajtjen, servisimin, instalimin dhe funksionalizimin e sistemeve të mbikëqyrjes me kamera.

Qëllimi i këtyre aktiviteteve ka qenë sigurimi i funksionimit të pandërprerë të sistemeve të kamerave, rritja e nivelit të sigurisë në objektet publike, si dhe garantimi i monitorimit efikas të hapësirave me rëndësi publike.

**Aktivitetet e realizuara:**

Gjatë periudhës raportuese janë realizuar aktivitetet në vijim:

- Është kryer mirëmbajtja dhe kontrolli teknik i sistemeve të kamerave në të gjitha shkollat fillore të Komunës së Deçanit.
- Është realizuar mirëmbajtja e sistemit të kamerave në Shkollën e Mesme Teknike **"Tafil Kasumaj".**
- Është kryer mirëmbajtja dhe servisimi i sistemit të kamerave në Qendrën për Punë Sociale (QPS).
- Është bërë instalimi dhe vendosja e sistemit të kamerave në objektin e Komunës së Deçanit.
- Është realizuar instalimi dhe funksionalizimi i sistemit të kamerave në Zyrën e Informimit.
- Është kryer mirëmbajtja e vazhdueshme e sistemit të kamerave të qytetit, duke përfshirë kontrollet periodike, eliminimin e defekteve, zëvendësimin e pajisjeve të dëmtuara sipas nevojës, si dhe testimin e vazhdueshëm të funksionalitetit të sistemit.

Të gjitha aktivitetet janë realizuar në përputhje me planin e kontratës dhe kanë kontribuar në ruajtjen e funksionalitetit të sistemeve të mbikëqyrjes, përmirësimin e sigurisë në institucionet publike dhe garantimin e monitorimit të qëndrueshëm të hapësirave publike.

- Gjatë këtij gjashtëmujori ka nisur implementimi dhe funksionalizimi i projektit WIFI4WB - rrjeti WIFI në Qendrën Rinore "Fetnete Ramosaj" Deçan, EU4Digital – i bashkë financuar nga BE dhe Qeveria Gjermane, dhe i zbatuar nga GIZ.

## 9. Pjesëmarrje në takime, punëtori dhe trajnime

Pjesëmarrje në takime, punëtori, trajnime: (Zyrtari i Lartë për Menaxhimin e Mbeturinave):

- Trajnim informues për raportimin në platformën digjitale për mbeturina 3 shkurt, GIZ Kosovo në Prishtinë;
- Zhvillimi i Metodologjisë për Mbulimin e Plotë të Kostos në Menaxhimin e Mbeturinave", organizim me qëllim të avancimit të qëndrueshmërisë financiare të sektorit të mbeturinave në nivel lokal, 25 mars 2026 Hotel Garden, Kalabria, Prishtinë;
- Misioni i vlerësimit për projektin e ri "Avancimi i Ekonomisë Qarkore në Kosovë", 17 qershor 2026, hotel Dukagjini në Pejë. Projekti do të financohet nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Gjermane dhe do të implementohet nga GIZ, duke filluar nga dhjetori i vitit 2026 deri më nëntor të vitit 2030 dhe synon të avancojë kornizën e menaxhimit të mbeturinave në Kosovë dhe të promovojë praktikat e ekonomisë qarkore, duke mbështetur harmonizimin e mëtejshëm të kornizës ligjore dhe institucionale me standardet e BE-së, forcimin e kapaciteteve zbatuese, zhvillimin e një sistemi operacional ndërkomunal të menaxhimit të integruar të mbeturinave në Zonën e Menaxhimit të Mbeturinave 3 – Pejë.

| Të dhëna të përgjithshme për Komunën e Deçanit | |
|---|---|
| Hapësira e përgjithshme | **293.94 km$^2$** |
| Popullsia | **27.775** |
| Gjithsej rrugë në territorin e komunës<br>Lokale<br>Regjionale<br>Rrugë të asfaltuara për periudhën raportuese (2025)<br>Rrugë të pajisura me shenjëzim vertikal dhe horizontal<br>Trotuare<br>Shtigje të biçikletave<br>Ndriçimi publik i rrugëve | **416.975 km**<br>**354.61 km**<br>**62.36 km**<br>**40.9 km (40.900 m)**<br>**309 km**<br>**79.5 km**<br>**65 km**<br>**190 km** |
| Hapësirat publike të përgjithshme<br>Hapësira publike me ndriçim | **50**<br>**49** |
| Hapësira publike<br>Hapësira të gjelbra | **337174.2 m$^2$ (337.1472 ha)**<br>**289097.2 m$^2$ (289.10 ha)** |

- **Transporti Rrugor – Publik**

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 është bërë përcjellja e rregullt e linjave të transportit publik urban dhe rural në qytetin e Deçanit dhe fshatrat e tij.

| Nr. | Aktiviteti | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës, Inspektoratin dhe institucionet tjera | 1 | – | 2 | – | – | 1 | **4** |
| **2** | Kontrolli i transporteve ilegale dhe respektimi i orareve | 2 | – | 3 | 2 | 3 | 5 | **15** |
| **3** | Caktimi i linjave dhe vazhdimi i lejeve të transportit | 1 | – | – | – | – | 10 | **11** |
| **4** | Pëlqime për regjistrimin e taksistëve | 6 | – | – | – | – | – | **6** |
| **5** | Kontrolli i transportit të udhëtarëve dhe mallrave | 5 | – | – | – | – | – | **5** |
| **6** | Kontrolli i vendqëndrimeve të taksive | ● | ● | ● | ● | ● | ● | |
| **7** | Mbikëqyrja e rendit dhe orarit të operatorëve | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | **6** |
| **8** | Përkujdesja për sinjalizimin horizontal dhe vertikal | ● | ● | ● | ● | ● | ● | |
| **9** | Leje për pengesa në rrugë dhe prerje të asfaltit | – | – | 2 | 4 | 1 | 3 | **10** |
| **10** | Vërtetime për studentë dhe punëtorë administrativë | 5 | 4 | 1 | 3 | 3 | 4 | **20** |
| **11** | Procesverbale, aktvendime dhe kërkesa për gjykata | – | – | 3 | – | – | – | **3** |

**Shënim:** (–) nuk ka aktivitet gjatë muajit, ndërsa (●) paraqet aktivitet të vazhdueshëm.

## GRAFIKU I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE






**PËRFUNDIM:** Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Sektori i Transportit Rrugor ka realizuar me sukses detyrat dhe përgjegjësitë e tij, duke kontribuar në rritjen e sigurisë në komunikacion, mbikëqyrjen e transportit publik dhe ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët dhe operatorët ekonomikë.

## ➢ Drejtoria për Inspekcion

Drejtoria për Inspekcion e Komunës së Deçanit, përkatësisht inspektorët e kësaj drejtorie, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit kalendarik 2026, kanë kryer punët dhe detyrat e punës në përputhje me ligjet, aktet nënligjore dhe rregulloret komunale me të cilat rregullohet veprimtaria e inspektorëve sipas fushave përkatëse, duke u bazuar në Planin e Punës së Drejtorisë për vitin 2026.

Duke u bazuar në shkresën zyrtare të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINT), si dhe në Ligjin për Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut Nr. 08/L-279, pozita e punës së Inspektorit Komunal të Tregut është shuar nga data 06.02.2026. Si rrjedhojë, funksioni i inspektimit të tregut organizohet dhe ushtrohet vetëm në nivel qendror, përkatësisht në kuadër të Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut.

Drejtoria për Inspekcion ka hartuar draft-rregulloren për **Plotësimin e Kushteve Minimale Teknike në Komunën e Deçanit**. Megjithatë, kjo draft-rregullore nuk është proceduar për miratim në Kuvendin Komunal për shkak të shuarjes së pozitës së Inspektorit të Tregut në nivel lokal.

Shuarja e kësaj pozite të punës ka ndikuar në mënyrë negative në mbikëqyrjen e subjekteve afariste lokale, si dhe në realizimin e të hyrave komunale. Aktualisht, në kuadër të Drejtorisë për Inspekcion, pozitë të rregullt të punës ka vetëm Inspektorja për Mbrojtjen e Mjedisit. Ndërsa, Inspektori i Ndërtimit ka vepruar me kontratë mbi shërbime të veçanta nga muaji shkurt deri në muajin maj 2026. Po ashtu, edhe Inspektori i Veterinës, i angazhuar me kontratë mbi shërbime të veçanta, ka vepruar gjatë së njëjtës periudhë.

Nga muaji shkurt 2026, Drejtoria për Inspekcion nuk ka pasur udhëheqës të drejtorisë dhe as ushtrues detyre të pozitës së drejtorit.

Inspektorët, sipas fushave të tyre përkatëse të inspektimit, kanë kryer kontrolle dhe mbikëqyrje në subjektet afariste. Inspektori i Tregut ka vepruar nga muaji janar deri më datën 06.02.2026, ndërsa Inspektori i Ndërtimit dhe Inspektori i Veterinës kanë vepruar nga muaji shkurt deri në muajin maj 2026, duke mbikëqyrur ndërtimet, si dhe kontrollin e produkteve bujqësore dhe produkteve të qumështit.

Inspektorja për Mbrojtjen e Mjedisit, në përputhje me përgjegjësitë e saj zyrtare, ka vepruar në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, përfshirë mbrojtjen e ujit, ajrit, tokës dhe biodiversitetit, si dhe në fusha të tjera që ndërlidhen me kompetencat e saj.

Drejtoria për Inspekcion ka realizuar inspektime të përbashkëta me:

- Stacionin Policor;
- Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale;
- Inspektoratin e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut.

Këto inspektime kanë pasur për qëllim koordinimin dhe realizimin e mbikëqyrjeve të përbashkëta me institucionet përgjegjëse.

Inspektimet e realizuara gjatë kësaj periudhe ndahen në:

- **Inspektime të planifikuara** – inspektime të realizuara në përputhje me Planin e Punës dhe Planin e Monitorimit të Drejtorisë;
- **Inspektime të paplanifikuara** – inspektime të realizuara në raste të veçanta, sipas nevojës dhe vlerësimit profesional të inspektorit, si dhe në bazë të kërkesave të personave fizikë dhe juridikë të paraqitura përmes sistemit Intranet;
- **Ri-inspektime** – inspektime përcjellëse të kryera pas kalimit të afatit të përcaktuar nga inspektori, me qëllim verifikimin e përmbushjes së urdhrave dhe eliminimin e parregullsive të konstatuara gjatë inspektimit.

Gjatë punës së tyre, inspektorët kanë dhënë këshilla profesionale subjekteve të inspektuara për zbatimin sa më korrekt të legjislacionit në fuqi dhe eliminimin e mangësive të evidentuara. Po ashtu, janë ndërmarrë masa administrative dhe janë shqiptuar gjoba me qëllim parandalimin dhe shmangien e rreziqeve që mund t'i shkaktohen shëndetit publik, sigurisë publike, mjedisit dhe interesave të ligjshme të personave fizikë dhe juridikë, në përputhje me ligjet në fuqi.

Janë ndërmarrë veprime edhe ndaj shkeljeve serioze, veçanërisht në rastet e ndërtimeve në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe kushtet urbanistike të përcaktuara nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit, si dhe janë lëshuar njoftime për ndërtime pa leje.

Duke qenë se pozita e Inspektorit të Tregut është shuar, zyrtarja e cila ka ushtruar këtë detyrë, me qëllim që të mos mbetet vakant funksioni brenda drejtorisë, është angazhuar në kryerjen e detyrave administrative, si:

- shqyrtimi i kërkesave përmes sistemit Intranet;
- lëshimi i fletëpagesave;
- administrimi i taksave administrative dhe gjobave për fushën e mjedisit përmes sistemit Intranet, në përputhje me ligjet, udhëzimet administrative dhe rregulloret komunale përkatëse.

Duhet të theksohet se, përveç aktiviteteve të lartcekura, janë kryer edhe punë dhe detyra të tjera në përputhje me fushëveprimtarinë dhe përgjegjësitë e secilit inspektor.

Në tabelën në vijim po e prezantojmë aktivitetin e inspektorëve:

<table>
<tr><th>Pozita zyrtare</th><th>Inspektime në teren sipas detyrës zyrtare</th><th>Inspektime sipas kërkesës së personave fizik dhe juridik</th><th>Aktvendime</th><th>Gjoba mandatorë</th><th>Inspektime për leje të ndërtimit</th><th>Inspektime për leje mjedisore</th><th>Kërkesa për gjykatë</th></tr>
<tr><td>Inspektorja për mbrojtje të mjedisit</td><td>21</td><td rowspan="4">51</td><td rowspan="4">15</td><td rowspan="4">1</td><td rowspan="4">6</td><td rowspan="4">6</td><td rowspan="4">0</td></tr>
<tr><td>Inspektori i tregut</td><td>10</td></tr>
<tr><td>Inspektori i ndërtimit</td><td>18</td></tr>
<tr><td>Inspektori i Veterinës</td><td>8</td></tr>
<tr><td>Gjithsej</td><td>57</td><td>51</td><td>15</td><td>1</td><td>6</td><td>6</td><td>0</td></tr>
</table>

## ➢ Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim

### 1. Hyrje

Ky raport paraqet përmbledhjen e aktiviteteve, angazhimeve institucionale, bashkëpunimeve, nismave dhe rezultateve kryesore të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim të Komunës së Deçanit për periudhën 01 janar - 30 qershor 2026.

Gjatë këtij gjashtëmujori, fokusi i punës së drejtorisë ka qenë orientuar në zhvillimin ekonomik lokal, shërbimet për biznese, promovimin e turizmit, fuqizimin e kapaciteteve të Qendrës Informuese Turistike - Visit Deçani, bashkëpunimin me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe përgatitjen dhe shtyrjen përpara të projekteve që ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës.

Drejtoria ka vepruar duke u mbështetur në Planin e Punës për vitin 2026, me orientim strategjik që Deçani të konsolidohet si qendër e vlerave natyrore, kulturore dhe turistike, duke krijuar vlerë për ekonominë lokale dhe për komunitetin.

### 2. Përmbledhje ekzekutive

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 janë realizuar aktivitete të rëndësishme në disa drejtime: planifikim dhe koordinim institucional, përfaqësim i Deçanit në ngjarje turistike ndërkombëtare, zhvillim i projekteve infrastrukturore dhe turistike, mbështetje për organizata dhe klube lokale, bashkëpunim me donatorë dhe partnerë zhvillimorë, si dhe ofrim i shërbimeve për bizneset përmes sektorit përkatës/ARBK-së.

- Përgatitja dhe zbatimi i aktiviteteve në kuadër të Planit të Punës 2026 të Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim.
- Përfaqësimi i Komunës së Deçanit në panaire dhe takime ndërkombëtare për promovimin e turizmit dhe destinacionit Deçan.
- Koordinimi me KIESA, MINT, MZHR, AKK/Kolegjiumin për Zhvillim Ekonomik, JICA, Swisscontact/PPSE, KFOR/CIMIC dhe partnerë të tjerë.
- Shtyrja përpara e projekteve turistike dhe infrastrukturore, përfshirë përgatitjen e projektit për 8 ura lidhëse në zonën malore, zhvillimin e ofertës malore dhe promovimin e atraksioneve ekzistuese.
- Mbështetja e organizatave joqeveritare, klubeve dhe iniciativave që pasurojnë ofertën turistike dhe sportive të Deçanit.
- Fuqizimi i rolit të Visit Deçani si pikë informuese, promovuese dhe operative për turizmin lokal.
- Vazhdimi i shërbimeve për biznese përmes sektorit të bizneseve/Zyrës së ARBK-së në Deçan.

### 3. Struktura funksionale e drejtorisë

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim gjatë periudhës raportuese ka ushtruar përgjegjësitë e saj kryesisht përmes dy fushave funksionale:

- Sektori i bizneseve/Zyra e ARBK-së në Deçan - shërbime për regjistrim, ndryshim, plotësim dokumentacioni, këshillim dhe komunikim me bizneset lokale.
- Sektori i turizmit/Visit Deçani - promovim i destinacionit, koordinim i aktiviteteve turistike, mbështetje për vizitorë, bashkëpunim me partnerë dhe zhvillim i produkteve turistike.

Puna është zhvilluar në bashkëpunim me kabinetin e Kryetarit, drejtoritë tjera komunale, organizatat lokale, institucionet qendrore, partnerët ndërkombëtarë dhe komunitetin e bizneseve.

**4. Aktivitetet kryesore sipas muajve**

| Periudha/Data | Aktiviteti | Përshkrimi | Rezultati |
|---|---|---|---|
| Janar 2026 | Planifikimi vjetor i punës | Finalizimi i orientimeve të punës për vitin 2026 dhe përcaktimi i prioriteteve në zhvillim ekonomik, turizëm, projekte dhe bashkëpunim institucional. | Bazë e qartë për zbatimin e aktiviteteve gjatë vitit. |
| Shkurt 2026 | Vazhdimi i mandatit dhe koordinimi institucional | Pas riemërimit në detyrë, u vazhdua puna në kuadër të prioriteteve të drejtorisë, me fokus në turizëm, biznese dhe projekte zhvillimore. | Vazhdimësi menaxheriale dhe institucionale. |
| 11 shkurt 2026 | Kapacitete njerëzore në turizëm - JICA | U vlerësua përfundimi i trajnimit të z. Lendim Kuçi në Wakayama të Japonisë, në kuadër të bashkëpunimit me JICA. | Rritje e kapaciteteve profesionale në menaxhim dhe turizëm të qëndrueshëm. |
| 18 shkurt 2026 | Kërkesë për Strategjinë e Turizmit | U përgatit kërkesë për bashkëfinancim të hartimit të Strategjisë së Turizmit, me qëllim orientimin e zhvillimit turistik të Deçanit. | Hap konkret drejt planifikimit afatgjatë të turizmit. |

| Periudha/Data | Aktiviteti | Përshkrimi | Rezultati |
|---|---|---|---|
| 25 shkurt 2026 | Bashkëpunim në kuadër të IPA CBC Albania-Kosovo | U shqyrtua/mbështet iniciativa për partneritet të asociuar në projektin "Via Castanea", me fokus në pyjet e gështenjës, biodiversitet dhe shteg të ri tematik. | Zgjerim i mundësive për projekte ndërkufitare. |
| Mars 2026 | Koordinim me partnerët e NaturKosovo/CELIM | U zhvillua komunikim për çështje të dokumentacionit, automjeteve dhe koordinimit të bashkëpunimit në kuadër të projektit NaturKosovo. | Përmirësim i koordinimit me partnerët zbatues. |
| 12-14 mars 2026 | Panairi Holiday World & Region World - Pragë | Komuna e Deçanit u përfaqësua në panairin turistik në Pragë dhe u zhvilluan kontakte institucionale, përfshirë komunikim/takim me përfaqësimin diplomatik të Kosovës. | Promovim ndërkombëtar i Deçanit si destinacion malor e kulturor. |
| 15 mars 2026 | Kupa e Skijimit "Bjeshka e Madhe 2026" | U realizua aktivitet sportivo-turistik në Bjeshkën e Madhe, duke promovuar potencialin dimëror të Deçanit. | Promovim i turizmit dimëror dhe i aktiviteteve malore. |
| Mars-Prill 2026 | Letra dhe takime me partnerë zhvillimorë | U zhvillua komunikim institucional me UTK, HELP, GIZ dhe partnerë të tjerë për mundësi bashkëpunimi dhe mbështetjeje. | Rritje e rrjetit të bashkëpunimit për zhvillim ekonomik. |

| Periudha/Data | Aktiviteti | Përshkrimi | Rezultati |
|---|---|---|---|
| 02 prill 2026 | KFOR/CIMIC - mbështetje për kërkim-shpëtim | U përgatit/komunikua lista e pajisjeve të nevojshme për Stacionin e Kërkim-Shpëtimit Malor në Deçan. | Hap i rëndësishëm për sigurimin e vizitorëve në zonat malore. |
| 08 prill 2026 | Takim me KIESA | U zhvillua takim me Drejtorin e KIESA-s, z. Nol Buzhala, dhe ekipin përkatës për bashkëpunim, informim të bizneseve dhe promovim të mundësive ekonomike. | Forcim i lidhjes mes komunës, bizneseve dhe skemave mbështetëse. |
| 20-22 prill 2026 | Vizitë studimore Grenoble/Chambéry | Në kuadër të Swisscontact/AKK u zhvilluan takime me përfaqësues lokalë dhe pjesëmarrje në panairin Mountain Planet. | Përvoja të reja për menaxhim destinacioni dhe turizëm malor. |
| 30 prill 2026 | Punëtori JICA - GSTC | U mor pjesë në punëtorinë për standardet e turizmit të qëndrueshëm dhe rezultatet praktike për Prizrenin dhe Deçanin. | Orientim praktik për menaxhim të qëndrueshëm të destinacionit. |
| 06-29 maj 2026 | Thirrje për OJQ-të në fushën e turizmit | U publikua dhe u promovua thirrja komunale për mbështetjen e projekteve të OJQ-ve që pasurojnë ofertën turistike të Deçanit. | Nxitje e iniciativave lokale në turizëm, sport dhe promovim. |

| Periudha/Data | Aktiviteti | Përshkrimi | Rezultati |
|---|---|---|---|
| Qershor 2026 | Projekti për 8 ura lidhëse në zonën malore | U punua në dokumentacion dhe koordinim për projektin e ndërtimit të 8 urave lidhëse në zonën malore të Deçanit. | Përmirësim i qasjes, sigurisë dhe lidhjes së zonave turistike e rurale. |
| 18 qershor 2026 | Donacion nga KFOR/CIMIC | Në ambientet e Visit Deçani u pranua donacioni me pajisje për kërkim-shpëtim malor dhe siguri të vizitorëve. | Fuqizim i kapaciteteve operative për ndërhyrje dhe siguri në terren. |
| 24-30 qershor 2026 | Përgatitje për vizitë studimore në Harz National Park | U përgatit dokumentacioni dhe pjesëmarrja për vizitën studimore në Gjermani në kuadër të bashkëpunimit rajonal për Bjeshkët e Nemuna. | Përgatitje për shkëmbim përvojash në menaxhim të natyrës dhe turizmit. |

### 5. Zhvillimi ekonomik dhe shërbimet për biznese

Në fushën e zhvillimit ekonomik, drejtoria ka vazhduar të ofrojë shërbime për bizneset lokale dhe të mbajë komunikim të vazhdueshëm me institucionet qendrore dhe partnerët zhvillimorë. Sektori i bizneseve/Zyra e ARBK-së ka shërbyer si pikë e parë kontakti për ndërmarrësit, duke ofruar informim, orientim dhe mbështetje administrative.

#### 5.1. Shërbime dhe komunikim me bizneset

- Ofrimi i shërbimeve të rregullta për bizneset përmes Zyrës së ARBK-së në Deçan.
- Informimi dhe orientimi i bizneseve lidhur me procedurat administrative dhe mundësitë e bashkëpunimit.
- Komunikimi me ARBK-në për çështje të qasjes në sistem dhe përmirësim të funksionimit të shërbimeve lokale.
- Bashkëpunimi me KIESA për mundësi të organizimit të sesioneve informuese dhe promovim të skemave mbështetëse për bizneset.

Raporti nuk vendos shifra të pa verifikuara për ARBK-në; evidenca numerike ruhet në sistemin përkatës dhe mund t'i bashkëngjitet dokumentit si aneks zyrtar, nëse kërkohet nga Kryetari, Kuvendi Komunal ose organet mbikëqyrëse.

| Kategoria e shërbimit | Përshkrimi |
|---|---|
| Regjistrim i bizneseve të reja | Shërbim i ofruar në vazhdimësi për ndërmarrësit lokalë. |
| Ndryshime dhe plotësime në të dhënat e bizneseve | Mbështetje administrative sipas kërkesave të palëve dhe procedurave të ARBK-së. |
| Certifikata dhe ekstrakte | Lëshim dhe orientim i palëve sipas nevojës. |
| Mbyllje/shuarje të bizneseve | Trajtim i kërkesave sipas procedurave zyrtare. |
| Këshillim dhe orientim për biznese | Informim për procedura, mundësi bashkëpunimi dhe kontakte institucionale. |

## 6. Turizmi dhe promovimi i destinacionit Deçan

Turizmi mbetet një prej fushave kryesore të punës së drejtorisë. Në këtë periudhë është punuar në promovimin e Deçanit si destinacion me potencial të lartë për turizëm malor, kulturor, aventurier dhe të qëndrueshëm. Aktivitetet janë zhvilluar përmes Visit Deçani, bashkëpunimit me organizata lokale, partnerëve zhvillimorë dhe përfaqësimit në ngjarje jashtë vendit.

### 6.1. Promovimi i destinacionit

- Përfaqësimi i Deçanit në panairin Holiday World & Region World në Pragë, me fokus promovimin e ofertës turistike, natyrës, kulturës, shtigjeve dhe potencialit për turizëm aktiv.
- Vazhdimi i promovimit të Deçanit përmes Visit Deçani, rrjeteve sociale, materialeve informuese dhe komunikimit me vizitorë, operatorë dhe partnerë.
- Puna për profilizimin e Deçanit si destinacion “outdoor”, duke përfshirë komunikimin rreth atraksioneve malore, dimërore dhe aventuriere.
- Promovimi i potencialit dimëror përmes organizimit/mbështetjes së Kupës së Skijimit “Bjeshka e Madhe 2026”.
- Përgatitja e përmbajtjeve promovuese për vizitorë dhe investitorë, përfshirë materiale për paraqitje vizuale dhe prezantim institucional.

### 6.2. Visit Deçani dhe shërbimet turistike

- Visit Deçani ka vazhduar të shërbejë si mekanizëm informues, promovues dhe koordinues për turizmin lokal.
- Është mbështetur komunikimi me vizitorë, grupe, operatorë, organizata dhe partnerë që lidhen me turizmin malor, kulturor dhe aventurier.
- Është vazhduar mbështetja për aktivitete që përfshijnë ecje, çiklizëm, ski, promovim të liqeneve, bjeshkëve dhe atraksioneve të Deçanit.

- Është koordinuar bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtarë për zhvillimin e produkteve turistike, sigurinë në terren dhe menaxhimin e destinacionit.

### 6.3. Siguria në turizëm dhe kërkim-shpëtimi malor

Një element i rëndësishëm i zhvillimit të turizmit malor është siguria e vizitorëve. Në këtë drejtim, drejtoria ka mbështetur funksionimin dhe fuqizimin e Stacionit të Kërkim-Shpëtimit Malor në Deçan, si strukturë që ndërlidhet me Visit Deçani dhe me nevojat e turizmit në zonën malore.

- Përgatitja e listës së pajisjeve të nevojshme për mbështetje nga KFOR/CIMIC.
- Pranimi i donacionit nga KFOR/CIMIC më 18 qershor 2026 për pajisje që ndihmojnë kërkim-shpëtimin dhe sigurinë e vizitorëve.
- Rritja e kapaciteteve për ndërhyrje, orientim dhe reagim në situata të mundshme emergjente në terrenet malore.

## 7. Projekte zhvillimore dhe infrastrukturore

Në fushën e projekteve zhvillimore, drejtoria ka punuar në përgatitje, koordinim dhe shtyrje përpara të iniciativave që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në turizëm, qasje, siguri dhe ekonomi lokale.

| Projekti/Nisma | Statusi gjatë P1/2026 | Ndikimi i pritur |
|---|---|---|
| Ndërtimi i 8 urave lidhëse në zonën malore | Përgatitje dhe koordinim dokumentacioni për bashkëfinancim/zbatim | Përmirësim i qasjes në zona malore, siguri më e lartë dhe lidhje më e mirë e pikave turistike. |
| Strategjia e Turizmit për Komunën e Deçanit | Kërkesë për bashkëfinancim dhe përgatitje orientimesh | Planifikim afatgjatë, rritje e cilësisë së ofertës dhe koordinim i investimeve. |
| Via Castanea - iniciativë ndërkufitare | Shqyrtim dhe partneritet i asociuar | Zhvillim i një produkti tematik me fokus në gështenja, biodiversitet dhe trashëgimi natyrore. |
| Via Dinarica / Peaks of the Balkans / shtigje malore | Promovim, koordinim dhe bashkëpunim me partnerë | Forcim i pozitës së Deçanit në rrjetet rajonale të turizmit malor. |

| Projekti/Nisma | Statusi gjatë P1/2026 | Ndikimi i pritur |
|---|---|---|
| Zip Line, Via Ferrata dhe oferta aventuriere | Komunikim/promovim dhe koordinim institucional | Zgjerim i ofertës së turizmit aktiv dhe rritje e atraktivitetit për vizitorë. |
| Deçani Outdoor / materialet promovuese | Punë në identitet promovues dhe përmbajtje vizuale | Prezantim më i qartë i Deçanit si destinacion natyror, malor dhe sportiv. |

**8. Bashkëpunimi institucional dhe ndërkombëtar**

Gjatë gjashtëmujorit të parë 2026, drejtoria ka zhvilluar bashkëpunim aktiv me institucione vendore, organizata ndërkombëtare, donatorë dhe partnerë zhvillimorë. Ky bashkëpunim ka pasur rëndësi të veçantë për shkëmbim përvojash, sigurim mbështetjeje, ngritje kapacitetesh dhe promovim të Deçanit jashtë vendit.

| Partneri/Institucioni | Forma e bashkëpunimit |
|---|---|
| JICA | Trajnim, punëtori GSTC dhe shkëmbim përvojash në turizëm të qëndrueshëm. |
| KIESA | Takim për bashkëpunim, informim të bizneseve dhe promovim të mundësive ekonomike. |
| Swisscontact/PPSE dhe AKK | Vizitë studimore, tema të menaxhimit të destinacionit dhe zhvillimit të turizmit malor. |
| KFOR/CIMIC | Mbështetje me pajisje për kërkim-shpëtim malor dhe siguri të vizitorëve. |
| MZHR | Koordinim për projekte infrastrukturore dhe zhvillim rajonal. |

| Partneri/Institucioni | Forma e bashkëpunimit |
|---|---|
| UTK, HELP, GIZ | Komunikim dhe kërkim mundësish për bashkëpunim në fusha zhvillimore. |
| IPA CBC Albania-Kosovo / INDEP | Mundësi partneriteti në projekt ndërkufitar për turizëm dhe biodiversitet. |
| Organizata dhe klube lokale | Mbështetje për aktivitete turistike, sportive dhe promovuese brenda territorit të Deçanit. |

**9. Mbështetja për OJQ, klube dhe iniciativat lokale**

Në përputhje me orientimin për zhvillim të turizmit dhe sportit në komunë, drejtoria ka vazhduar të mbështesë organizatat, klubet dhe iniciativat që kontribuojnë në pasurimin e ofertës turistike dhe promovimin e Deçanit.

- Publikimi dhe promovimi i thirrjes për OJQ-të në fushën e turizmit, me afat aplikimi deri më 29 maj 2026.
- Orientimi i thirrjes drejt projekteve që pasurojnë ofertën turistike, nxisin aktivitetet në natyrë dhe forcojnë imazhin e Deçanit si destinacion aktiv.
- Bashkëpunimi me organizata lokale dhe klube që merren me turizëm, sport, çiklizëm, ecje malore, aktivitete ujore dhe promovim të natyrës.
- Mbështetja morale, institucionale dhe promovuese për aktivitetet që sjellin vizitorë dhe gjallëri në komunë.

**10. Komunikimi publik dhe promovimi në rrjete sociale**

Komunikimi publik ka qenë pjesë e rëndësishme e punës së drejtorisë, sidomos në fushën e turizmit. Përmes Visit Deçani dhe kanaleve komunale është vazhduar promovimi i atraksioneve, aktiviteteve, ngjarjeve dhe potencialeve zhvillimore të komunës.

- Publikime për aktivitetet turistike, takimet institucionale dhe përfaqësimin e Deçanit në ngjarje vendore dhe ndërkombëtare.
- Promovim i bjeshkëve, liqeneve, shtigjeve, produkteve turistike, aktiviteteve sportive dhe natyrore.
- Përgatitje e teksteve institucionale dhe promovuese për postime, ftesa, falënderime dhe komunikime zyrtare.
- Fokus i veçantë në gjuhë të kujdesshme institucionale, pa personalizim të tepruar dhe me theks në Komunën e Deçanit dhe Visit Deçani.

## 11. Rezultatet kryesore të gjashtëmujorit

| Fusha | Rezultati |
|---|---|
| Promovimi i turizmit | Deçani u promovua në nivel vendor dhe ndërkombëtar përmes panaireve, takimeve, materialeve dhe aktiviteteve në terren. |
| Kapacitetet institucionale | U rritën kapacitetet dhe kontaktet profesionale për menaxhim destinacioni, turizëm të qëndrueshëm dhe zhvillim ekonomik. |
| Siguria në turizëm | U sigurua mbështetje konkrete me pajisje për kërkim-shpëtim malor nga KFOR/CIMIC. |
| Projektet zhvillimore | U avancuan dokumentacioni dhe koordinimi për projekte me rëndësi, përfshirë urat lidhëse në zonën malore dhe strategjinë e turizmit. |
| Bashkëpunimi me bizneset | U vazhduan shërbimet për bizneset dhe u hapën kanale komunikimi me institucione mbështetëse si KIESA. |
| Partneritetet | U zgjerua rrjeti i bashkëpunimit me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë. |
| OJQ dhe komuniteti lokal | U krijuan mundësi për mbështetje të projekteve që pasurojnë ofertën turistike dhe nxisin aktivitetet lokale. |

## 12. Sfidat e evidentuara

- Nevoja për të dhëna më të sakta dhe më të shpejta statistikore lidhur me bizneset, vizitorët dhe efektet ekonomike të aktiviteteve turistike.
- Kërkesa për buxhet më të qëndrueshëm për mirëmbajtje të infrastrukturës turistike, sinjalistikë, pajisje dhe promovim profesional.
- Nevoja për koordinim më të fortë ndërmjet institucioneve, operatorëve, OJQ-ve dhe komunitetit për menaxhim të përbashkët të destinacionit.
- Mungesa e një sistemi të plotë të monitorimit të vizitorëve dhe matjes së ndikimit ekonomik të turizmit në komunë.
- Nevoja për finalizim të dokumenteve strategjike dhe planifikim të qartë të investimeve në zonat turistike.

## 13. Prioritetet për gjashtëmujorin e dytë 2026

- Vazhdimi i punës për Strategjinë e Turizmit të Komunës së Deçanit dhe orientimi i saj drejt zbatimit praktik.
- Ndjekja e procesit për projektin e 8 urave lidhëse në zonën malore dhe koordinimi me partnerët përkatës.
- Zhvillimi i aktiviteteve promovuese për sezonin veror dhe dimëror, me fokus në Visit Deçani dhe ofertën "outdoor".
- Rritja e bashkëpunimit me bizneset lokale dhe organizimi i sesioneve informuese për mundësitë e mbështetjes institucionale.
- Fuqizimi i Stacionit të Kërkim-Shpëtimit Malor dhe përmirësimi i mekanizmave të sigurisë për vizitorë.
- Mbështetja e OJQ-ve dhe klubeve të turizmit/sportit për aktivitete që sjellin vizitorë dhe ndikim pozitiv ekonomik.
- Krijimi i evidencave më të rregullta për indikatorët e punës: biznese, aktivitete, vizitorë, projekte, partneritete dhe komunikim publik.

## 14. Përfundim

Gjashtëmujori i parë i vitit 2026 ka qenë periudhë e rëndësishme për konsolidimin e punës së Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim. Puna është karakterizuar nga vazhdimësi institucionale, përfaqësim aktiv i komunës, bashkëpunim me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, promovim i turizmit dhe përgatitje e projekteve që synojnë zhvillim afatgjatë.

Deçani ka potencial të madh, por ky potencial nuk shndërrohet vetë në zhvillim ekonomik. Për këtë arsye, puna e drejtorisë duhet të vazhdojë me disiplinë më të madhe në matje, dokumentim, projektim dhe zbatim. Vetëm përmes planeve konkrete, partneriteteve të qëndrueshme dhe rezultateve të matshme mund të arrihet që turizmi dhe zhvillimi ekonomik të kenë ndikim real në mirëqenien e qytetarëve.

## ➢ Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër

### 1. Shefi i Shërbimit dhe Zyrtari për RDPP me Referentin e Ndryshimeve Kadastrale

Gjatë periudhës raportuese, Zyrtari për Regjistrimin e të Drejtave në Pronën e Paluajtshme (RDPP), i cili njëkohësisht ushtron edhe funksionet e Shefit të Shërbimit, ka pranuar gjithsej 300 kërkesa nga palë të ndryshme për realizimin e të drejtave ligjore në pronë.

- Nga këto kërkesa, 288 janë shqyrtuar dhe për secilën është lëshuar aktvendim adekuat, ku ose është njohur e drejta ligjore e kërkuar nga pala, ose është refuzuar me të drejtën për ankim në organin e shkallës së dytë.
- 12 kërkesa të tjera janë në procedurë e sipër.

Aktvendimet pozitive në RDPP dërgohen në referentin për ndryshime kadastrale, i cili bën azhurnimin e librave të elaboratit kadastral dhe futjen e të dhënave në sistemin elektronik (programi SIKTK).

Përveç këtyre detyrave, Zyrtari për RDPP dhe Shefi i Shërbimit, bashkë me Referentin për ndryshime kadastrale, kanë kryer edhe punë të tjera sipas urdhrit të drejtorit.

**2. Zyrtarët e Mirëmbajtjes së Kadastrit**

Në këtë sektor janë të angazhuar tre zyrtarë, të cilët gjatë periudhës raportuese kanë kryer 210 azhurnime të lëndëve në terren bazuar në kërkesat e palëve. Këto azhurnime përfshijnë:

- Ndarjen dhe bashkimin e parcelave
- Regjistrimin e objekteve
- Korrigjimin e sipërfaqeve dhe mexhave
- Futjen e të dhënave të reja në sistem

Nga këto, vetëm 10 raste janë ende në procedurë.

Gjithashtu, këta zyrtarë kanë lëshuar 9 historiate dhe identifikime të mexhave dhe 269 kopje plani sipas kërkesave të palëve.

**3. Referenti për Pranimin e Palëve**

Gjatë periudhës raportuese, referenti për pranimin e palëve ka pranuar 912 kërkesa, kryesisht për dhënien e certifikatave të pronës së paluajtshme, kopjeve të planit dhe vërtetimeve për gjendjen e pronësisë në territorin e Komunës së Deçanit.

Të gjitha kërkesat janë proceduar dhe palët janë pajisur me dokumentacionin përkatës brenda ditës së paraqitjes së kërkesës.

Ky zyrtar ka kryer edhe detyrat e përpunuesit në sistemin SIKTK.

**4. Përmbledhje e Performancës së Drejtorisë**

Gjatë periudhës raportuese, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadaster ka përpunuar gjithsej 1683 lëndë të ndryshme nga të gjitha shërbimet që ofrohen. Përveç punëve të përmendura më lart, Drejtoria ka kryer edhe detyra të tjera sipas kërkesave të palëve private dhe organeve komunale, duke kontribuar në zhvillimin e shërbimeve cilësore në fushën e pronësisë dhe kadastrit në Komunën e Deçanit.

## ➢ Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Deçanit ka realizuar një sërë aktivitetesh kulturore, rinore dhe sportive, të mbështetura nga buxheti komunal, me qëllim të zhvillimit dhe promovimit të kulturës, sportit, rinisë dhe vlerave tradicionale të komunës.

**Aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive të realizuara (me financim nga Komuna);**

- **11.02.2026** – Tryezë diskutimi me të rinjtë e Komunës së Deçanit me temën: *"Rrugëtimi drejt lirisë dhe pavarësisë"*.
- **16.02.2026** – Promovimi i librit *"99+1 Personalitetet e Deçanit dhe Junikut"*, nga autori Adem Lushaj.
- **15.03.2026** – Gara e skitarisë *"Bjeshka e Madhe"*.
- **23.03.2026** – Ekspozitë e artistëve nga mbarë vendi, kushtuar 24 Marsit – *"Epopeja e Dukagjinit"*.
- **25.03.2026** – Takim me studentët nga Universiteti Teknik i Vjenë.
- **18.04.2026** – Takim me të rinjtë e Deçanit.
- **05.05.2026** – Organizimi i aktiviteteve me të rinjtë në nderim të *"Ditës së Dëshmorëve"*.
- **13.05.2026** – Ceremonia e diplomimit të maturantëve të Gjimnazit *"Vëllezërit Frashëri"*.
- **21.05.2026** – Takim me të rinjtë e Deçanit.
- **29.05.2026** – Aktiviteti *"Dita e Shkollës"*, organizuar nga Gjimnazi Teknik *"Tafil Kasumaj"*.
- **01.06.2026** – Aktiviteti për *"Ditën e Fëmijëve"*, piknik në Qendrën Rinore.
- **09.06.2026** – Tryezë shkencore me temën: *"Ruajtja dhe promovimi i folklorit burimor në ditët e sotme përmes festivaleve folklorike*.
- **15.06.2026** – Ekspozita *"Universi Kreativ"*, nga piktori Ukë Lataj.
- **15–16.06.2026** – Festivali Gjithëkombëtar i Folklorit *"Eshkë e Ndezur mbi Shkëlzen"*, organizuar në nderim të *"Ditës së Çlirimit"*.
- **19.06.2026** – Aktivitet me nxënësit e klasës së pestë.

**Aktivitetet e institucioneve kulturore dhe rinore**

**Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Deçani"**

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, Ansambli i Këngëve dhe Valleve *"Deçani"* ka përfaqësuar me sukses Komunën e Deçanit në festivale të ndryshme kulturore, duke arritur rezultate të mira dhe duke fituar çmime të rëndësishme.

Gjithashtu, gjatë muajit qershor, Ansambli ka përfaqësuar Republikën e Kosovës në Suedi, duke promovuar kulturën dhe traditën shqiptare jashtë vendit.

**Biblioteka e Qytetit "Dëshmorët e Lirisë"**

Gjatë kësaj periudhe, Biblioteka e Qytetit *"Dëshmorët e Lirisë"* ka pasur:

- 52 lexues të regjistruar;
- vizita të shumta nga nxënësit dhe të rinjtë;
- donacione të librave nga shkrimtarë vendorë dhe të huaj.

**Muzeu Etnologjik i Deçanit**

Muzeu Etnologjik i qytetit të Deçanit ka qenë i hapur për vizitorë gjatë gjithë gjashtëmujorit dhe ka pranuar vizita të shumta nga qytetarë dhe turistë.

Po ashtu, fondi i muzeut është pasuruar me artefakte të reja të dhuruara nga qytetarët e Komunës së Deçanit.

**Kompleksi Kulturor "Fetnete Ramosaj"**

Kompleksi Kulturor *"Fetnete Ramosaj"* ka qenë aktiv gjatë kësaj periudhe duke organizuar dhe zhvilluar aktivitete të ndryshme kulturore, përfshirë:

- ngjarje kulturore;
- seminare;
- trajnime;
- promovime;
- koncerte;
- ekspozita;
- vizita të shumta nga turistët vendorë dhe ndërkombëtarë, veçanërisht ata që vizitojnë Deçanin për aktivitete malore (hiking).

**Këshilli i Veprimit Rinor Lokal (KVRL)**

KVRL ka qenë aktiv gjatë këtij gjashtëmujori, duke marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe duke realizuar aktivitete të iniciuara nga vetë të rinjtë.

**Investimet në infrastrukturë sportive**

Punimet për ndërtimin e **Pishinës Gjysmëolimpike** kanë vazhduar edhe gjatë kësaj periudhe.

Në fushën e sportit janë arritur rezultate të rëndësishme, si në aspektin e suksesit sportiv, ashtu edhe në mbështetjen financiare për klubet sportive dhe organizatat joqeveritare që veprojnë në Komunën e Deçanit.

**RAPORT I PUNËS**

**Arkivi Komunal i Deçanit**

**Periudha: Janar–Qershor 2026**

Arkivi Komunal i Deçanit funksionin e tij e ushtron në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, rregulloret e pushtetit qendror dhe aktet e pushtetit lokal.

Punonjësit e këtij sektori janë angazhuar në klasifikimin, sistemimin dhe ruajtjen e dokumentacionit arkivor, me qëllim të menaxhimit sa më efikas të lëndëve arkivore.

Gjatë periudhës janar–qershor 2026, në Arkivin Komunal të Deçanit janë realizuar punë dhe detyra të përcaktuara sipas programit të punës, me qëllim të ruajtjes, administrimit dhe ofrimit të dokumentacionit arkivor për shfrytëzim.

Në kuadër të administratës komunale janë funksionalizuar disa aplikacione për administratë elektronike, si:

- SMAED;
- E-Arkivi;
- Intraneti.

Gjatë kësaj periudhe, Arkivi Komunal ka pasur kërkesa nga palë të ndryshme për shfrytëzim të dokumentacionit arkivor. Lëndët e kërkuara kanë përfshirë:

- raporte të LAL Kunorave;
- aktgjykime;
- aktvendime;
- vendime të ndryshme dhe dokumente të tjera zyrtare.